

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

PRODHIM SHTAZOR

Niveli II

(Në drejtimin mësimor BUJQËSI)

Kodi: H5-II-18

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2018

Përmbajtja:

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II, të drejtimit mësimor “Bujqësi”.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Prodhim shtazor”, niveli II.

IV. Udhëzime për planin mësimor

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II,

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II, të drejtimit “Bujqësi”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar apo vetëpunësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me punimet dhe shërbimet në prodhimin shtazor”*. Zhvillimi të nxënësit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gadishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimit emocionale, intelektuale dhe profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale i’u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse si dhe vlerat e tyre morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional të profilit “Prodhim shtazor”, niveli II.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin “Prodhim shtazor” niveli II, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Bujqësi”, niveli I;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë MFE përgatit udhëzime të veçanta për pranimin në këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II, nxënësi do të ketë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënësve dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II.

Në përfundimin me sukses të arsimit profesional në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të organizojë vendin e punës.
- Të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.
- Të respektojë standardet e profesionit.
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit.
- Të kujdeset për çeljen natyrale dhe artificiale të zogjve.
- Të trajtojë kafshët për prodhim qumështi dhe mishi.
- Të trajtojë shpendët për prodhim mishi dhe vezësh.
- Të kujdeset për riprodhimin e kafshëve
- Të qethë dhentë.
- Të kujdeset për rritjen e mbarështrimin e kafshëve të punës.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë drejtim profesional. Ky arsimim profesional i jep nxënësit mundësi t'i drejtohet tregut të punës si punonjës i kualifikuar në ndërmarrje/ferma të ndryshme blegtorale ose veprimtari të tjera që veprojnë në fushën e prodhimit shtazor. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual ose familjar në këtë fushë. Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin III (teknik/manazherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin/profilin përkatës, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

II. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Prodhim shtazor”, niveli II

Plani mësimor për profilin mësimor “Prodhim shtazor”, niveli II			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-10	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-28-202-12	Zookultura	2
3	L-28-203-11	Të ushqyerit dhe rritja e kafshëve	2
4	L-28-204-11	Riprodhimi i kafshëve	1
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-28-554-12	Kujdesi gjatë çeljes së zogjve	51
2	M-28-881-12	Kujdesi gjatë rritjes së pulave të detit dhe shpendëve të ujit	51
3	M-28-555-12	Trajtimi i kafshëve për prodhim qumështi e mishi	69
4	M-28-556-11	Trajtimi i shpendëve për prodhim mishi e vezësh	69
5	M-28-562-12	Kujdesi gjatë rritjes artificiale të peshkut	66
6	M-28-558-11	Qethja e dhenve	51
7	M-28-559-12	Kujdesi për rritjen e mbarështimin e kafshëve të punës	51
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-28-557-11	Kujdesi për riprodhimin e lopëve	51
2	M-28-560-11	Kujdesi gjatë rritjes së shpendëve dekorativ	51
3	M-28-561-11	Kujdesi gjatë rritjes së krimbit të mëndafshit	51
4	M-28-563-11	Marrja e mjaltit nga zgjoi i bletës	51
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/ 1054)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Prodhim shtazor”, niveli II, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për profilet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Prodhim shtazor”, niveli II.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënësit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilin profesional “Prodhim shtazor”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Prodhim shtazor”, niveli II, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e prodhimit shtazor dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit II.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Rritje e kafshëve dhe e shpendëve”, niveli II

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Rritje e kafshëve dhe e shpendëve”, niveli II, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit II.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-10). Kl. 12 – 68 orë

- **Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “ Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjithë elementët kryesorë të saj.
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore.
- Të shpjegojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes.
- Të shpjegojnë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes.
- Të përshkruajnë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të.
- Të përshkruajnë llojet e konsumatorëve, kërkesat specifike për mallra/shërbime dhe reagimet e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje.
- Të shpjegojnë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes.
- Të shpjegojnë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre.
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut.
- Të listojnë katër *P*-të e marketingut.
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës.
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen	3 orë
Tema 2	Sipërmarrja dhe aktiviteti njerëzor	4 orë
Tema 3	Sipërmarrja dhe biznesi	8 orë
Tema 4	Organizimi i punës në biznes	9 orë
Tema 5	Tregu dhe sjellja konsumatore	6 orë
Tema 6	Institucionet financiare	7 orë
Tema 7	Njohuri për Marketingun	5 orë
Tema 8	Legjislacioni dhe etika e biznesit	5 orë
Tema 9	Legjislacioni i punës	7 orë
Tema 10	Llogaritje të thjeshta ekonomike	10 orë
Tema 11	Aspekte të TIK-ut në biznes	4 orë

2. Lënda “Zookultura” (L-28-202-12) Kl. 12 - 68 orë

- **Synimet e lëndës “Zookultura”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Zookultura” klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë e rritjes, karakteristikat dalluese të racave të shpendëve si dhe leverdinë ekonomike që ka rritja e tyre.
- Të përshkruajnë ndërtimin anatomik e fiziologjik të trupit të shpendëve (pula, gjel deti, rosa, pata).
- Të klasifikojnë, sipas cilësive të eksteriorit, shpendët (pula, gjel deti, rosa, pata).

- Të rendisin faktorët e mjedisit që ndikojnë në prodhimin e vezëve e të mishit të shendëve (pula, gjel deti, rosa, pata).
- Të përshkruajnë metodat e shumëzimit të shpendët (pula, gjel deti, rosa, pata), si dhe të bëjnë dallimin mes çeljes natyrore e asaj artificiale.
- Të theksojnë kushtet që duhet të plotësojnë vendet dhe sheshet e ndërtimit për rritjen e mbajtjen e shpendëve (pula, gjel deti, rosa, pata).
- Të përcaktojnë komponentet më kryesorë për të ndërtuar një racion ushqimor për shpend (pula, gjel deti, rosa, pata).
- Të tregojnë rëndësinë ekonomike të rritjes së bletës e të përshkruajnë përbërjen e familjes “bletë”.
- Të përshkruajnë ndërtimin anatomik të bletës si dhe kushtet që duhen krijuar për shtimin intensiv të bletës.
- Të theksojnë përparësitë që ka shtimi artificial i bletës.
- Të shpjegojnë pse realizohet kontrolli pranveror e ai dimëror i bletëve.
- Të klasifikojnë sëmundjet e bletëve.
- Të përshkruajnë rëndësinë dhe anatominë e peshkut.
- Të klasifikojnë llojet e peshqve.
- Të përshkruajnë kushtet e rritjes e shtimit artificial të peshqve.
- Të dallojnë llojet e krimbit të mëndafshit.
- Të theksojnë kushtet që duhet të plotësohen për rritjen e shtimin e krimbit të mëndafshit.
- Të përshkruajnë llojet e shpendëve dekorativ si dhe kushtet e rritjes e shtimit të tyre.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Zookulturë”, kl.12-68 orë**

Tema 1	Rëndësia ekonomike e rritjes së shpendëve	1 orë
Tema 2	Pamja e jashtme dhe racat e shpendëve	8 orë
Tema 3	Anatomia dhe fiziologjia e shpendëve	2 orë
Tema 4	Teknologjia e rritjes dhe e trajtimit të shpendëve	11 orë
Tema 5	Të ushqyerit e pulave	4 orë
Tema 6	Të ushqyerit e gjelit të detit	2 orë
Tema 7	Të ushqyerit e rosave e patave	2 orë
Tema 8	Rëndësia ekonomike e mbarshtrimit të bletëve	1 orë
Tema 9	Mbarështrimi i familjeve bletë	10 orë
Tema 10	Të ushqyerit, organizimi dhe teknika e shtegimit të bletëve	9 orë
Tema 11	Njohja me sëmundjet kryesore të bletëve	2 orë
Tema 12	Rritja dhe mbarshtrimi artificial i peshkut	10 orë
Tema 13	Rritja dhe mbarshtrimi i krimbit të mëndafshit	4 orë
Tema 14	Rritja dhe mbarshtrimi i shpendëve dekorativ	2 orë

3. Lënda “Të ushqyerit dhe rritja e kafshëve” (L-28-203-12) Kl.12-68 orë

• **Synimet e lëndës “Të ushqyerit dhe rritja e kafshëve” kl.12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Të ushqyerit dhe rritja e kafshëve” kl.12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë e rritjes së gjedhit si dhe karakteristikat dalluese të racave të gjedhit dhe leverdinë ekonomike që ka rritja e tyre.
- Të përshkruajnë ecurinë e kurbës së laktacionit dhe rëndësinë e periudhës së tharjes lidhur me prodhimin e qumështit.

- Të rendisin faktorët që ndikojnë në prodhimin dhe ruajtjen e qumështit.
- Të rendisin komponentët kryesorë për të hartuar një racion ushqimor në varësi të gjendjes fiziologjike të kategorive të ndryshme të gjedhit.
- Të tregojnë ndikimin që ka secili nga ushqimet më të përdorshme në të ushqyerit e gjedhëve.
- Të përshkruajnë kushtet që duhen plotësuar për higjienën e lopëve dhe qumështit
- Të përshkruajnë karakteristikat e eksteriorit sipas drejtimeve.
- Të rendisin kriteret organoleptike për klasifikimin e leshit, llojet e qimeve.
- Të përshkruajnë mënyrat e mbarështrimit të dhenve, si dhe përzgjedhjen e dhenve.
- Të llogarisin nevojat energjetike, proteinike të dhenve për mbajtjen e trupit, barsmërinë, prodhimin e qumështit e shtesën e peshës.
- Të klasifikojnë ushqimet më të përdorshme të dhenve.
- Të përshkruajnë racat e dhive dhe rëndësinë ekonomike të rritjes së tyre.
- Të tregojnë si bëhet të ushqyerit e dhive gjatë periudhave të ndryshme të vitit në varësi të gjendjes fiziologjike dhe në llojet e sasive të disponueshme të ushqimeve.
- Të rendisin kushtet kryesore që duhen pasur parasysh në të ushqyerit e kecape.
- Të tregojnë rëndësinë e mbarështrimit të derrave dhe veçoritë biologjike të tyre.
- Të dallojnë racat e derrave dhe të përshkruajnë karakteristikat dalluese.
- Të llogarisin vlerat e racioneve ushqimore sipas gjendjes fiziologjike të derrave.
- Të klasifikojnë ushqimet më të përshtatshme të derrave.
- Të dallojnë racat e kuajve dhe rëndësinë e mbarështrimit të tyre.
- Të përshkruajnë mënyrat e mbarështrimit të kuajve.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Të ushqyerit dhe rritja e kafshëve” kl.12-68 orë**

Tema 1	Rëndësia ekonomike e rritjes, pamja e jashtme dhe racat e gjedhit	7 orë
Tema 2	Periudha laktacionit, tharja, higjiena e lopëve të qumështit	9 orë
Tema 3	Të ushqyerit e gjedhit	10 orë
Tema 4	Rëndësia ekonomike e rritjes, pamja e jashtme dhe racat e dhenve	7 orë
Tema 5	Mbarshtrimi i dhenve	9 orë
Tema 6	Higjiena e lokaleve të rritjes së dhenve	2 orë
Tema 7	Rritja dhe mbarshtrimi i dhive	5 orë
Tema 8	Rëndësia ekonomike e rritjes, pamja e jashtme dhe racat e derrave	7 orë
Tema 9	Mbarshtrimi i derrave	6 orë
Tema 10	Rritja dhe mbarshtrimi i kuajve	6 orë

4. Lënda “Riprodhimi i kafshëve” (L-28-204-12) Kl. 12 - 34 orë

• **Synimet e lëndës “Riprodhimi i kafshëve”, kl. 12 – 34 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Riprodhimi i kafshëve” klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë objektin e studimit të riprodhimit të kafshëve dhe ndërtimin anatomik të organeve gjinore femërore dhe mashkullore.
- Të përshkruajnë funksionin dhe fiziologjinë e organeve gjinore femërore dhe mashkullore.
- Të krahasojnë ndërtimin e organeve gjinore femërore në kafshë të ndryshme.

- Të përshkruajnë ndërtimin anatomik të gjirit të lopët dhe të përshkruajë fiziologjinë e gjirit.
- Të tregojnë veçoritë anatomike të gjirit të kafshët e tjera bujqësore.
- Të tregojnë kuptimin e pjekurisë seksuale dhe asaj trupore të kafshëve.
- Të diferencojnë pjekurinë seksuale nga ajo trupore.
- Të përkufizojnë çfarë është cikli seksual.
- Të përshkruajnë periudhat e ciklit seksual.
- Të tregojnë karakteristikat e ciklit seksual të kafshët bujqësore.
- Të përshkruajnë ndryshimet e organeve gjinore tek kafshët në afsh.
- Të përshkruajnë ndërzimin si një proces reflektor.
- Të theksojnë rëndësinë praktike të njohjes së reflekseve seksuale.
- Të tregojnë mënyrat e ndërzimit.
- Të përshkruajnë periudhat e procesit të pllenimit.
- Të përshkruajnë periudhat e zhvillimit embrional.
- Të përshkruajnë ndryshimet anatomike dhe fiziologjike të kafshët barse.
- Të përshkruajnë zgjatjen e mbarsmërisë në kafshë të ndryshme.
- Të përcaktojnë pozicionin e mitrës të lopët në muaj të ndryshëm të mbarsmërisë.
- Të tregojnë kujdesin për kafshën barse.
- Të përkufizojnë procesion e pjelljes.
- Të përshkruajnë shenjat paralajmëruese të pjelljes.
- Të përshkruajnë fazat e procesit të pjelljes.
- Të tregojnë veçoritë e pjelljes në kafshë të ndryshme, kujdesin dhe ndihmën për kafshën gjatë pjelljes.
- Të përshkruajnë trajtimin e kafshëve pas pjelljes dhe trajtimin e të porsalindurve.
- Të përkufizojnë çfarë janë dështimet në kafshë.
- Të përcaktojnë shkaqet dhe llojet e dështimeve në kafshë.
- Të përshkruajnë shenjat klinike në pjelljet e vështira.
- Të përshkruajnë metodat gjatë ndërhyrjeve në pjelljet e vështira.
- Të rendisin shkaqet që çojnë në shfaqjen e asfiksionit, ftohjes trupore dhe hipoglicemisë tek kafshët e porsalindura.
- Të përshkruajnë shenjat klinike në kafshët e porsalindura me asfiksion, ftohje trupore, hipoglicemi.
- Të përcaktojnë masat parandaluese dhe mjekimin për patologjitë e kafshëve të porsalindura.

■ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Riprodhimi i kafshëve”, kl. 12 – 34 orë**

Tema 1	Rëndësia dhe objekti i riprodhimit të kafshëve	1 orë
Tema 2	Fiziologjia e organeve femërore gjinore dhe mashkullore	4 orë
Tema 3	Anatomia dhe fiziologjia e gjirit	3 orë
Tema 4	Pjekuria seksuale, trupore dhe cikli seksual	3 orë
Tema 5	Ndërzimi dhe pllenimi i kafshëve	5 orë
Tema 6	Mbarsmëria dhe pjelljet në kafshë	5 orë
Tema 7	Kujdesi dhe trajtimi i kafshëve para dhe pas pjelljes	6 orë
Tema 8	Patologjitë e barrës	4 orë
Tema 9	Sëmundjet e kafshëve të porsalindura.	3 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli: “Kujdesi gjatë çeljes së zogjve”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Prodhim shtazor
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KUJDESI GJATË ÇELJES SË ZOGJVE	(M-28-554-12)
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer përgatitjen e furrikut, ajrosjen e vezëve dhe kontrollin e çeljes së zogjve në kushte natyrore dhe artificiale, si dhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me çeljen e zogjve.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen procese përgatitore për çeljen natyrore të zogjve.</p> <p>Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja e veshjes për shërbimet që do kryhen.– Përcaktimi i radhës së punës.– Përzgjedhja e mjeteve dhe e vendit për çeljen e zogjve.– Dezinfektimi i vendit ku do vendoset furriku.– Përgatitja e furrikut.– Vendosja e furrikut në vendin e caktuar.– Përzgjedhja e kllaçkës.– Përzgjedhja e vezëve që do çelin.– Vendosja e vezëve në furrik.– Shtrimi i kllaçkës.– Sigurimi i ujit dhe ushqimit të mjaftueshëm për kllaçkën.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së ambjentit gjatë kryerjes së proceseve përgatitore për çeljen natyrore të zogjve. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.– Pyetje dhe përgjigje me gojë. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë uniformën për kryerjen e shërbimeve.– të përcaktojë radhën e duhur të punës për çeljen natyrore të zogjve.	

- të përzgjedhë mjetet dhe vendin për çeljen e zogjve.
- të dezinfektojë vendin ku do vendoset furriku
- të përgatisë furrikun sipas numrit të vezëve që do të vendosen për çelje.
- të vendosë furrikun në vendin e caktuar.
- të përzgjedhë kulloçkën sipas kondicionit.
- të përzgjedhë vezët që do çelin, sipas standardit.
- të vendosë vezët në furrik në pozicionin e duhur.
- të shtrojë kulloçkën.
- të sigurojë ujë dhe ushqim të mjaftueshëm për kulloçkën.
- të zbatojë rregullat të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së ambjentit gjatë kryerjes së proceseve përgatitore për çeljen natyrore të zogjve.

RM 2 Nxënësi kujdeset për çeljen natyrore të zogjve.

Përmbajtja

- Përgatitja e veshja e uniformës së punës.
- Rrotullimi dhe ajrosja e vezëve pas daljes së kulloçkës nga furriku.
- Kontrolli i vezëve të çelura.
- Largimi i vezëve të paçelura.
- Sigurimi i ambjentit të përshtatshëm për zogjtë e çelur dhe kulloçkën.
- Sigurimi i ujit dhe ushqimit të mjaftueshëm për kulloçkën dhe zogjtë.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së ambjentit gjatë kujdesit për çeljen e zogjve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë uniformën e duhur.
- të përcaktojë radhën e punës.
- të rrotullojë dhe ajrosë vezët pas daljes së kulloçkës nga furriku.
- të kontrollojë vezët e çelura.
- të largojë vezët e paçelura.
- të sigurojë ambjentin e përshtatshëm për zogjtë dhe kulloçkën.
- të sigurojë ujë dhe ushqim të mjaftueshëm për kulloçkën dhe zogjtë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesit të çeljes së zogjve

RM 3 Nxënësi kryen punë përgatitore për çeljen artificiale të zogjve.

Përmbajtja

- Përgatitja e veshja për shërbimet në repart.

- Përcaktimi i rradhës së punës.
- Dezinfektimi i këmbëve përpara hyrjes në repartin e inkubacionit.
- Përzgjedhja e mjeteve dhe dezinfektantit për dezinfektimin e repartit të inkubacionit.
- Dezinfektimi i repartit të inkubacionit.
- Përzgjedhja e vezëve për inkubacion.
- Larja e vezëve.
- Dezinfektimi i vezëve.
- Kontrolli i parametrave në repartin e inkubacionit.
- Vendosja e vezëve në pozicionin e duhur në karela në inkubatorin e çeljes.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së ambjentit gjatë kryerjes së punëve përgatitore për çeljen artificiale të zogjve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje dhe përgjigje me gojë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë uniformën e punës për shërbimet në repart.
- të përcaktojë radhën e punës.
- të dezinfektojë këmbët përpara hyrjes në repartin e inkubacionit.
- të përzgjedhë mjetet dhe dezinfektantin për dezinfektimin e repartit të inkubacionit.
- të lajë vezët me detergjente me bazë alkaline.
- të dezinfektojë vezët me dezinfektantë me bazë klori.
- të ruajë strukturën inkubuese të vezëve.
- të përzgjedhë vezët për inkubacion sipas treguesve.
- të kontrollojë parametrat në repartin e inkubacionit (temperaturën, lagështinë, ndriçimin, ventilimin e ajrit)
- të vendosë vezët në pozicionin e duhur në karela në repartin e inkubacionit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punëve përgatitore për çeljen artificiale të zogjve.

RM 4 Nxënësi kujdeset gjatë çeljes artificiale të zogjve.

Përmbajtja

- Përgatitja e veshja e uniformës së punës për shërbimet në repart.
- Përcaktimi i rradhës së punës.
- Dezinfektimi i këmbëve në vaskën e dezinfektimit.
- Kontrolli i parametrave në repartin e inkubacionit.
- Kthimi i vezëve.
- Kontrolli i sasisë së vezëve të çelura.
- Përzgjedhja dhe vendosja e zogjve të çelur në dhomën e

- tharjes.
- Seksimi i zogjve.
 - Ambalazhimi i zogjve për transport.
 - Sigurimi i higjienës në repartin e inkubatorit pas çeljes së zogjve.
 - Pastrimi i veglave dhe pajisjeve pas punës.
 - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së ambjentit gjatë kontrollit të çeljes artificiale të zogjve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë uniformën e duhur.
- të përcaktojë siç duhet radhën e punës.
- të dezinfektojë këmbët në vaskën e dezinfektimit.
- të kontrollojë parametrat në repartin e inkubacionit.
- të kthejë vezët me kujdes.
- të kontrollojë me kujdes sasinë e vezëve të çelura.
- të përzgjedhë dhe të vendosë zogjtë e çelur në dhomën e tharjes.
- të kryejë seksimin e zogjve.
- të kryejë ambalazhimin e zogjve për transport.
- të sigurojë higjienën në repartin e inkubatorit pas çeljes së zogjve.
- të pastrojë veglat dhe pajisjet pas punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit të çeljes artificiale të zogjve.

RM 3 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të çeljes natyrale e artificiale të zogjve.

Përmbajtja

- Kostot në punët e çeljen natyrale dhe artificiale të zogjve, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël (familjar) për çeljen natyrale e artificiale të zogjve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot në çeljen natyrale e artificiale të zogjve, si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.

- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport, amortizime dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për çeljen natyrale e artificiale të zogjve.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës dhe territore të tjera të përshtatshme pranë shkollës.
- Mësuesi/instruktori mund të organizojë edhe vizita në ferma blegtorale të cilat mbarështojnë shpend.
- Mësuesi/instruktori duhet të demonstrojë veprimtari konkrete pune për përgatitjen e furrikut, ajrosjen e vezëve dhe kontrollin e çeljes natyrale dhe artificiale të zogjve, si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur to.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune gjatë çeljes së zogjve në kushte natyrore për përgatitjen e furrikut, ajrosjen e vezëve dhe kontrollin e çeljes së zogjve, kujdesin gjatë çeljes artificiale të zogjve, si dhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me kujdesin për çeljen natyrale e artificiale të zogjve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune gjatë kujdesit për çeljen natyrale dhe artificiale të zogjve, fillimisht në mbikqyerje të instruktorit apo specialistit, pastaj në mënyrë të pavarur.
- Nxënësit duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryhen gjatë kujdesit të çeljes natyrale dhe artificiale të zogjve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për njohuritë e marra për çeljen e zogjve në kushte natyrore.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Baza prodhuese e shkollës ose fermë ku rriten shpendëve.
 - Pajisje dhe vegla pune për dezinfektimin e vendit dhe përgatitjen e furrikut.
 - Detergjentë dhe tretësira dezinfektuese.
 - Vezë për çelje, ushqim dhe ujë i pijshëm për kllloçkën, peshqirë, sapun e kova uji.
 - Pajisje kancelarie, makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zberthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimet e murit me tulla (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal
-

2. Kujdesi gjatë rritjes së pulave të detit dhe shpendëve të ujit

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Prodhim shtazor
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KUJDESI GJATË RRRITJES SË PULAVE TË DETIT DHE SHPENDËVE TË UJIT	(M-28-881-12)
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer mirëmbajtjen, funksionimin e pajisjeve e mjeteve për kujdesin gjatë rritjes së pulave të detit dhe shpendëve të ujit, si dhe të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të rritjes së pulave të detit dhe shpendëve të ujit.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”. Të ketë përfunduar modulin “Kujdesi gjatë çeljes së zogjve”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kujdeset për rritjen natyrale të zogjve të pulës së detit. Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja e veshjes dhe ambientit ku do të vendosen zogjtë e detit të sapoçelur.– Zgjedhja e mjeteve dhe paisjeve që përdoren në pastrimin e kotecit.– Llogaritja e madhësisë së kotecit.– Zbatimi i masave higjienike dhe klimatike në kotec.– Zbatimi i masave profilaktike dhe mjekuese në tufën e zogjve të detit.– Përzgjedhja e llojit të ushqimit dhe enëve përkatëse.– Përlllogaritja e racioneve ushqimore. sipas periudhave të rritjes– Përlllogaritja e vitaminave dhe lëndëve minerale në ushqim.– Përgatitja e ushqimit të parë.– Dhënia e ujit.– Trajtimi i zogjve të detit në fazën e daljes së <i>vathëve</i> dhe <i>lafshës</i>.– Mbajtja e shënimeve përkatëse për shërbimet dhe operacionet që kryhen gjatë rritjes natyrale të zogjve të detit.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes	

së ambjentit gjatë rritjes natyrale të zogjve të pulës së detit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatitë kompletin e veshjes dhe ambjentin ku do të vendosen zogjtë e detit të sapoçelur.
- Të përzgjedhë mjetet e paisjet që do të përdoren për pastrimin e kotecit.
- Të bëjë llogaritje të madhësisë së kotecit për zogjtë e pulave të detit të sapoçelur.
- Të zbatojë masat higjienike dhe klimatike në kotec.
- Të zbatojë masat profilaktike dhe mjekuese në tufën e zogjve të detit për sëmundjet infektive, parazitare dhe gjatë “krizës së skuqërimit”.
- Të përzgjedhë llojet e ushqimit për zogjtë e sapoçelur, si dhe enëve përkatëse për të ushqyerit e tyre.
- Të përlllogarisë racione ushqimore, sipas periudhave të rritjes si: miell misri, lakra ose hithra të grira, kos, hurrë, misër kokërr, ushqim të gjelbër, kullotat, etj.
- Të përlllogarisë sasinë e llojin e vitaminave dhe lëndëve minerale në ushqimin e zogjve.
- Të përgatisë ushqimin e parë të zogjve të tillë si: vezë të ziera të thërmuara.
- Të kryejë dhënie e ujit brenda në kotec.
- Të trajtojë zogjtë e detit në fazën e daljes së *vathëve* dhe *lafshës*.
- Të mbajë saktë shënimet përkatëse për shërbimet dhe operacionet që kryhen gjatë rritjes natyrale të zogjve të detit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së ambjentit gjatë rritjes natyrale të zogjve të pulës së detit.

RM 2 Nxënësi kujdeset për rritjen ekstensive të zogjve të pulave të detit.

Përmbajtja

- Përgatitja e veshjes dhe ambjentit ku do të vendosen zogjtë e inkubatorit.
- Llogaritja e madhësisë boksit për zogjtë e detit.
- Kontrolli i temperaturës dhe lagështisë në lokalit e rritjes.
- Zgjedhja e mjeteve dhe paisjeve për pastrimin e bokseve.
- Zbatimi i masave profilaktike dhe mjekuese në tufën e zogjve të detit.
- Vendosja dhe ndezja e kllonës.

- Lëvizja e lirshme e zogjve të detit në rrethore.
- Sigurimi i enëve të ushqimit dhe ujit.
- Përcaktimi i teknikës së të ushqyerit.
- Përlllogaritja e ushqimit në racione. sipas periudhave të rritjes
- Llogaritja e bilancit ushqimor me proteina, karbohidrate, vitamina, kripëra minerale e mikroelementë.
- Nxjerrja e zogjve të detit në kullotë.
- Sigurimi i kushteve të përshtatshme higjienike dhe klimatike në lokalitë e rritjes së zogjve të detit.
- Llogaritja e lëndëve ushqyese.
- Trajtimi i zogjve të detit për majmëri.
- Kombinimi ushqimor kullotë-koncentratë.
- Kujdesi për rritjen e intensitetit të shtesës së peshës.
- Kontrolli i peshës së pulës së detit.
- Mbajtja e shënimeve përkatëse për shërbimet dhe operacionet që kryhen gjatë rritjes intensive të zogjve të detit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të rritjes ekstensive të zogjve të detit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje dhe përgjigje me gojë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatitë uniformën e veshjes dhe ambientin ku do të vendosen zogjtë e inkubatorit.
- Të bëjë llogaritjen e madhësisë së boksit për zogjtë e detit, sipas moshës dhe peshës.
- Të kontrollojë në vazhdimësi temperaturën dhe lagështinë në lokalitë e rritjes së zogjve të detit.
- Të përzgjedhë mjetet dhe paisjet që përdoren për pastrimin e bokseve.
- Të zbatojë masave profilaktike dhe mjekuese në tufën e zogjve të detit për sëmundjet infektive dhe parazitare.
- Të vendosja e ngrohëses (kloçka bateri) në qendër të rrethores dhe ta ndezë atë 24 orë para ardhjes së zogjve.
- Të kontrollojë lëvizjen e lirshme e zogjve të detit në rrethore.
- Të sigurojë enët e ushqimit dhe të ujit brenda rrethores.
- Të zbatojë teknikën tradicionale të ushqyerit të zogjve të sapoçelur me të verdhë veze.
- Të ushqejë zogjtë në ditët e para të tyre 8-10 herë në ditë.

- Të përlllogarisë racionet ushqimore, sipas periudhave të rritjes.
- Të llogarisë bilancin ushqimor me nivel të lartë proteinik mbi 24% të përgatitur në fabrikat e ushqimeve të blegtorisë.
- Të nxjerrë zogjtë e detit në kullotë.
- Të sigurojë kushtet e përshtatshme higjenike dhe klimatike në lokalin e rritjes së zogjve të detit.
- Të llogarisë lëndët ushqyese, sipas periudhës së rritjes duke përdorur në racionin ushqimor, ushqime të koncentruar si: misër kokërr, miell misri të verdhë, sojë, bathë, bizele, bërsi soje dhe bërsi lule dielli.
- Të trajtojë zogjtë e detit për majmëri, në vjeshtë.
- Të bëjë kombinimin e ushqimit kullotë-koncentratë.
- Të kujdeset për rritjen e intensitetit të shtesës se peshës së zogjve që trajtohen për majmëri.
- Të kontrollojë peshën e pulës së detit sipas moshës së saj dhe kërkesës për tregëtim.
- Të mbajë saktë shënimet përkatëse për shërbimet dhe operacionet që kryhen gjatë rritjes ekstensive të zogjve të detit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të rritjes ekstensive të zogjve të detit.

RM 3 Nxënësi kujdeset për rritjen dhe ushqyerjen e shpendëve të ujit.

Përmbajtja

- Përgatitja e veshjes dhe ambientit ku do të vendosen shpendët e ujit (patat, rosat).
- Llogaritja e madhësisë së kotecit për patë/rosë
- Ndërtimi i kotecit të patave/rosave.
- Përzgjedhja e racës së patës/rosës.
- Zgjedhja e çiftit për shumim natyral.
- Rritja e patave/rosave gjatë gjithë vitit.
- Dezinfektimi i kotecit të patave/rosave.
- Zbatimi i masave higjenike dhe klimatike në kotec.
- Zgjedhja e mjeteve dhe paisjeve që përdoren për pastrimin e kotecit.
- Zgjedhja e ambientit ku do të vendoset furriku.
- Llogaritja e madhësisë së furrikut.
- Përgatitja e furrikut.
- Dezinfektimi i furrikut. me insekticid.
- Përcaktimi i numrit të vezëve dhe për zgjedhja e tyre për inkubim.
- Vendosja e patës/rosës kllukë në furrik.
- Çelja e vezëve të patës/rosës në mënyrë natyrale.
- Dhënia e ushqimit dhe e ujit bibave/rikave.

- Nxjerrja e bibave/rikave në kullotë me patat/rosat.
- Mbajtja në tufë ose grupe e patave/rosave në kotec.
- Shfrytëzimi i kullotës. sipas grupmohës dhe peshës
- Llogaritja e racionit ushqimor.
- Trajtimi i patave/rosave në majmëri.
- Përzgjedhja e mënyrës së ushqyerjes së patave/rosave për majmëri.
- Përzgjedhja e llojit të ushqimit për majmëri.
- Shkulja e pendëve të patave.
- Zbatimi i masave profilaktike dhe mjekuese në tufën e patave/rosave.
- Mbajtja e shënimeve përkatëse për shërbimet dhe operacionet që kryhen gjatë rritjes së patave/rosave.
- Zbatimi i masave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë rritjes së shpendëve të ujit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë veshjen dhe ambjentin ku do të vendosen shpendët e ujit.
- Të bëjë llogaritjen e madhësisë së kotecit për patë/rosë.
- Të ndërtojë një kotec të thjeshtë për pata/rosa.
- Të përzgjedhë racën e patës/rosës, sipas kërkesës (vezë, mish).
- Të zgjedhë çiftin e pataverosave për shumim natyral, 1 patok 3-5 pata, ndërsa 1 rosak 6-8 rosa.
- Të kujdeset për rritjen e patave/rosave gjatë gjithë vitit.
- Të dezinfektojë kotecin e patave/rosave.
- Të zbatojë masat higjienike dhe klimatike në kotec.
- Të zgjedhë mjetet dhe paisjet që përdoren për pastrimin e kotecit.
- Të zgjedhë ambjentin e përshtatshëm për ndërtimin e furrikut të patës/rosës.
- Të llogaritë madhësinë e furrikut bazuar në përmasat e kllukës dhe numrit të vezëve.
- Të përgatisë furrikun sipas madhësisë së patës dhe numrit të vezëve.
- Të dezinfektojë furrikun me insekticid.
- Të përcaktojë numrin e vezëve dhe t'i zgjedhë ato, sipas kriterëve të caktuara, për inkubim.
- Të vendosë patën kllukë në furrik.
- Të kontrollojë çeljen e vezëve të patës në mënyrë natyrale në ditë 30-31, ndërsa për rosën në ditën e 28-31.
- Të ushqejë bibat në ditët e para me miell misri ose gruri të pë përzier me vaj ulliri, si dhe t'u japë atyre ujë

të pastër dhe të freskët.

- Të ushqejë zogitë e sapoçelur me dhallë, hirrë, lakra të grira, kokrra të copëtuara etj., gjatë rritjes së tyre.
- Të nxjerrë bibat/rikat së bashku me patat/rosat në kullota livadhore me tërfil, jonxhë, bar etj.
- Të mbajë në tufë ose grupe patat/rosat në kotec.
- Të shfrytëzojë kullotën, sipas grupmohës dhe peshës
- Të llogarisë racionin ushqimor, sipas periudhës së rritjes.
- Të trajtojë patat/rosat për majmëri me ushqime që tretën lehtë.
- Të përdorë ushqyerjen natyrale të patave/rosave për majmëri si: hamulloret, misëroret pas korrijes, mbeturinat e industrisë ushqimore, etj.
- Të përzgjedhja e llojit të ushqimit për majmëri si: miell misri, miell elbi, miell tërshëre i situar, gështënja, patate të ziera, etj.
- Të shkulin pendët (puplave) të patave nga qafa, barku dhe gjoksi në periudhën e ndërrimit të pendëve.
- Të zbatojë masat profilaktike dhe mjekuese në tufën e shpendëve të ujit.
- Të mbajë saktë shënimet përkatëse për shërbimet dhe operacionet që kryhen gjatë rritjes së shpendëve të ujit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë rritjes së shpendëve të ujit.

RM 4 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të rritjes e të ushqyerit të pulave të detit dhe shpendëve të ujit.

Përmbajtja

- Kostot në punët e rritjes dhe të ushqyerit e pulave të detit dhe shpendëve të ujit, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël (familjar) për rritjen e pulave të detit dhe shpendëve të ujit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot në rritjen dhe të ushqyerit e pulave të detit dhe shpendëve të ujit, si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport, amortizime dhe

makineri), sipas manualit përkatës.

- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për rritjen dhe të ushqyerit e pulave të detit dhe shpendëve të ujit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës dhe territore të tjera të përshtatshme pranë shkollës.
- Mësuesi/instruktori mund të organizojë edhe vizita në ferma blegtorale të cilat mbarështojnë shpendë (pula deti dhe shpendë të ujit).
- Mësuesi/instruktori duhet të demonstrojë veprimtari konkrete pune për përgatitjen e furrikut, ajrosjen e vezëve dhe kontrollin e çeljes natyrale dhe artificiale të zogjve, të ushqyerit gjatë fazave të ndryshme të rritjes së pulave të detit dhe shpendëve të ujit, si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur to.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune gjatë çeljes së zogjve në kushte natyrore për përgatitjen e furrikut, ajrosjen e vezëve dhe kontrollin e çeljes së zogjve, kujdesin gjatë çeljes artificiale të zogjve, të ushqyerit e tyre gjatë fazave të ndryshme të rritjes, si dhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me rritjen e pulave të detit dhe shpendëve të ujit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune gjatë kujdesit për rritjen e pulave të detit dhe shpendëve të ujit, fillimisht në mbikqyerje të instruktorit apo specialistit, pastaj në mënyrë të pavarur.
- Nxënësit duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryhen gjatë rritjes së pulave të detit dhe shpendëve të ujit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për njohuritë e marra për çeljen e zogjve në kushte natyrore.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Baza prodhuese e shkollës ose fermë ku rriten shpendë.
 - Pajisje dhe vegla pune për dezinfektimin e vendit dhe përgatitjen e furrikut e pastrimin e kotecit.
 - Detergjentë dhe tretësira dezinfektuese.
 - Vezë për çelje, ushqim dhe ujë i pijshëm për kllloçkën, peshqirë, sapun e kova uji.
 - Pajisje kancelarie, makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zberthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimet e murit me tulla (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal
-

3. Moduli “Trajtimi i kafshëve për prodhim qumështi e mishi”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Prodhim shtazor
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	TRAJTIMI I KAFSHËVE PËR PRODHIM QUMËSHTI E MISHI	(M-28-555-12)
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për trajtimin e kafshëve në periudhën e laktacionit dhe trajtimin e kafshëve për mish, si dhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me trajtimin e kafshëve për prodhim qumështi e mishi.	
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi trajton lopët në periudhën e laktacionit. <i>Përmbajtja</i> <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja e veshjes për shërbimet në stallë.– Përzgjedhja e ambjentit për lopët e qumështit.– Sigurimi i kushteve higjienike në stallë.– Sigurimi i klimës së përshtatshme në stallë.– Përzgjedhja e veglave dhe e pajisjeve për pastrimin e trupit të lopëve.– Mbajtja e higjienës së trupit të kafshëve.– Përzgjedhja e veglave për ushqyerjen e lopëve.– Përzgjedhja e ushqimeve për lopët në laktacion.– Përlllogaritja e sasisë së qumështit për lopë.– Hartimi dhe përgatitja e racionit ushqimor.– Ndarja racionale e ushqimit për lopë.– Hedhja e ushqimit në grazhdë.– Përgatitja e lopëve për mjelje.– Mjelja e lopëve.– Grumbullimi i qumështit.– Paketimi i sasisë së qumështit për treg.– Ruajtja e qumështit.– Regjistrimi i të dhënave në kartelën përkatëse.– Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve e pajisjeve që përdoren gjatë trajtimit të lopëve në periudhën e laktacionit.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së ambjentit gjatë trajtimit të lopëve në laktacion.	

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë uniformën për kryerjen e shërbimeve në stallë.
- të përzgjedhë stalla me hapësirë të mjaftueshme për qëndrimin dhe lëvizjen e lopëve.
- të largojë në kohën e duhur plehun nga stalla.
- të pastrojë dhe dezinfektojë vendqëndrimin e kafshës.
- të sigurojë temperaturën dhe ajrimin normal të mjedisit në stallë.
- të kryejë pastrimin e lëkurës së trupit të kafshës sipas teknikës përkatëse.
- të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet që përdoren për pastrimin e trupit të lopëve
- të realizojë pastrimin dhe ruajtjen e higjienës së trupit të lopëve.
- të përzgjedhë mjetet e nevojshme për ushqyerjen e lopëve.
- të përllogaritë sasinë e qumështit që do të prodhohet nga çdo lope në laktacion.
- të përzgjedhë ushqimet për lopët në laktacion.
- të hartojë dhe përgatitë racionin ushqimor, sipas fazave të laktacionit.
- të bëjë ndarjen racionale e ushqimit për lopë.
- të hedhë me kujdes ushqimin në grazhdë.
- të përgatitë lopët për mjelje sipas kushteve higjieno-sanitare.
- të realizojë mjeljen me dorë ose në mënyrë mekanike sipas mundësive.
- të grumbullojë në enë të posaçme qumështit e mjelë.
- të paketojë qumështin e grumbulluar për treg sipas kërkesës.
- të ruajë në kushte të caktuara higjieno-sanitare qumështin e grumbulluar.
- të regjistrojë të dhënat e duhura, në kartelën përkatëse, për çdo lopë.
- të pastrojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet që përdoren për pastrimin e lopëve dhe ambjentit të tyre.
- të zbatojë rregullat të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së ambjentit gjatë trajtimit të lopëve në laktacion.

RM 2 Nxënësi trajton delet e dhinë gjatë periudhës së laktacionit.

Përmbajtja

- Përgatitja e uniformës së punës dhe mjeteve për trajtimin e deleve e dhive në laktacion.
- Përllogaritja e sasisë së ushqimit për trajtimin e deleve e dhive në laktacion.
- Përcaktimi i llojshmërisë së ushqimeve.

- Racionimi i ushqimeve për dele e dhi.
- Ushqyerja e deleve dhe e dhive në stalla.
- Përcaktimi dhe përgatitja e mjedisit për kullotjen e kafshëve.
- Kullotja e deleve dhe dhive në periudhën e laktacionit.
- Kujdesi për qengjat dhe kecat gjatë pirjes së kulloshtrës dhe qumështit tek nënat.
- Shkëputja e qengjave dhe kecape nga nënat.
- Kontrolli i peshës trupore të qengjave e kecape.
- Kujdesi për higjienën e gjirit në dele e dhi.
- Mjelja e e deleve dhe e dhive.
- Shënimi i sasisë së qumështit të mjelë.
- Grumbullimi i qumështit të mjelë.
- Paketimi i qumështit për treg.
- Regjistrimi i të dhënave në kartelën përkatëse.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve e pajisjeve që përdoren gjatë trajtimit të deleve e dhive në periudhën e laktacionit.
- Zbatimi i rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve dhe trajtimit të deleve e dhive.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë uniformën dhe veglat e nevojshme të punës për trajtimin e deleve e dhive në laktacion.
- të përllogaritë sasinë e ushqimit kundrejt numrit të kafshëve që mbarështohen.
- të përcaktojë llojshmërinë e ushqimeve që do të përdoren për trajtimin e kafshëve në laktacion sipas nevojës së kafshës në regjimin stallor si: hasëlle, bar i thatë, gjethe dushku, silazh, koncentrat, etj.
- të përgatisë racionin ushqimor për dhentë e dhitë në laktacion sipas prodhimit të qumështit
- të ushqejë kafshët në stalla, sipas vakteve të caktuara.
- të përgatisë mjedisin për ushqyerjen e kafshëve në kullotje të lirë.
- të realizojë kullotjen e lire të deleve dhe dhive në periudhën e laktacionit.
- të kujdeset për qengjat dhe kecat gjatë pirjes së kulloshtrës dhe qumështit tek nënat, në sasinë dhe kohën e duhur.
- të shkëputë qengjat dhe kecat nga nënat, në kohën e duhur.
- të kontrollojë peshën trupore të qengjave e kecape dhe kohën e shkëputjes nga nëna.
- të kujdeset vazhdimisht për higjienën e gjirit në dele e dhi (pastrimin, larjen dhe masazhimin e gjirit).
- të mjelë delet dhe dhitë sipas kohës së përcaktuar.
- të shënojë saktë sasisë e qumështit të mjelë, në kartelën përkatëse.

- të grumbullojë qumështin e mjelë në enë të posaçme.
- të paketojë qumështin për treg, sipas kërkesës.
- të ruajë qumështin në kushtet e duhura higjiono-sanitare.
- të regjistrojë saktë të dhënat në kartelën përkatëse.
- të pastrojë dhe mirëmbajë mjetet e pajisjet që përdorën gjatë trajtimit të deleve e dhive në periudhën e laktacionit.
- të përcaktojë dhe përgatisë territorin e duhur për kullotjen e deleve ose dhive.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve dhe trajtimit të deleve e dhive. gjatë laktacionit.

RM 3 Nxënësi trajton viçat për majmëri.

Përmbajtja

- Përgatitja dhe veshja e uniformës për shërbimet në stallë.
- Përzgjedhja e ambjentit për viçat e drejtimit për mish.
- Përzgjedhja e veglave dhe paisjeve për trajtimin e viçave për mish.
- Sigurimi i mikroklimes në stallë
- Sigurimi i kushteve higjenike në stallë.
- Përzgjedhja e viçave për majmëri.
- Përzgjedhja e veglave e materialeve për ushqyerjen e viçave.
- Përzgjedhja e ushqimeve për viçat me drejtim prodhim mishi.
- Përlogaritja e sasisë së ushqimeve për trajtimin e viçave për mish.
- Hartimi i racionit ushqimor. sipas grup moshave.
- Ndarja racionale e ushqimit kokë për kokë.
- Hedhja e ushqimit në grazhd.
- Sigurimi i ujit të pijshëm.
- Regjistrimi i të dhënave të duhura në kartelën përkatëse.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë trajtimit të viçave për majmëri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë e të veshë uniformën për trajtimin e viçave për majmëri.
- Të përzgjedhë ambjentin e përshtatshëm për viçat e majmërisë
- Të përzgjedhë veglat dhe paisjet për kryerjen e shërbimeve në stallë.
- Të sigurojë mikroklimën në stallë sipas standardit të kërkuar.
- Të sigurojë kushtet higjenike në stallë, sipas standardit të kërkuar.
- Të përzgjedhë viçat për majmëri, sipas kriterëve të duhura.
- Të përzgjedhë veglat e duhura për ushqyerjen e viçave.

- Të përlogarisë sasinë e ushqimeve për numrin e caktuar të viçave për majmëri.
- Të përzgjedhë saktë llojet e ushqimeve për trajtimin e viçave për majmëri.
- Të hartojë racionin ushqimor sipas grup moshave.
- Të bëjë ndarjen racionale të ushqimit kokë për kokë.
- Të kryejë hedhjen e ushqimit në grazhd.
- Të sigurojë sasinë e ujin të pijshëm të nevojshëm për viçat në majmëri.
- Të regjistrojë të dhënat e duhura në kartelën përkatëse për sejcilin viç.
- Të zbatojë drejtë masat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për trajtimin e viçave për majmëri.

RM 4 Nxënësi trajton derrat për majmëri.

Përmbajtja

- Përgatitja dhe veshja e uniformës për shërbimet në stallë.
- Përzgjedhja e ambientit për trajtimin e derrave për majmëri.
- Përzgjedhja e veglave dhe paisjeve për trajtimin e derrave për mish.
- Sigurimi i kushteve higjenike dhe i mikroklimës në stallë.
- Përzgjedhja e derrave për majmëri.
- Përcaktimi i numrit të krerëve të derrave që do të trajtohen në stallë për mish.
- Përzgjedhja e veglave për ushqyerjen e derrave.
- Përzgjedhja e ushqimeve për derrat me drejtim mishi.
- Përlogaritja e sasisë së ushqimeve për trajtimin e derrave për mish.
- Hartimi i racionit ushqimor.
- Ndarja racionale e ushqimit për kokë.
- Sigurimi i ujit të pijshëm.
- Regjistrimi i të dhënave të duhura në kartelën përkatëse.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë trajtimit të derrave për majmëri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë e të veshë uniformën për trajtimin e derrave për majmëri.
- Të përzgjedhë ambientin e përshtatshëm për derrat e majmërisë
- Të përzgjedhë veglat dhe paisjet për kryerjen e shëbimeve në stallë.
- Të sigurojë kushtet higjenike dhe mikroklimën në stallë sipas standardit të kërkuar.
- Të përzgjedhë derrat për majmëri, sipas kriterëve të duhura.
- Të përzgjedhë veglat e duhura për ushqyerjen e derrave.

- Të përlogarisë sasinë e ushqimeve për numrin e caktuar të derrave për majmëri.
- Të përzgjedhë saktë llojet e ushqimeve për trajtimin e derrave për majmëri.
- Të përlogarisë sasinë e nevojshme të ushqimeve për trajtimin e derrave për majmëri.
- Të hartojë racionin ushqimor sipas grup moshave.
- Të bëjë ndarjen racionale të ushqimit kokë për kokë.
- Të sigurojë sasinë e ujin të doemosdoshëm të pishëm për derrat në majmëri.
- Të regjistrojë të dhënat e duhura në kartelën përkatëse për sejcilin derr.
- Të zbatojë drejtë masat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për trajtimin e derrave për majmëri.

RM 3 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të trajtimit të kafshëve për prodhin qumështi e mishit.

Përmbajtja

- Kostot në trajtimin e kafshëve të qumështit dhe mishit, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël për trajtimin e kafshëve të qumështit e të mishit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot në trajtimin e kafshëve të qumështit dhe mishit, si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport, amortizime dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për trajtimin e kafshëve të qumështit dhe mishit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në territorin e fermës së shkollës dhe territore të tjera të përshtatshme pranë shkollës.
- Mësuesi/instruktori mund të organizojë edhe vizita në ferma blegtorale të cilat mbarështojnë lopë, dele e dhi me regjim stallor dhe kullor dhe që janë në periudhën e laktacionit, në rastet e trajtimit të kafshëve për mish (viça e derra), si dhe për llogaritjet e

thjeshta ekonomike që lidhen me trajtimin e kafshëve të qumështit dhe mishit.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të punëve që kryhen për trajtimin e të kafshëve gjatë periudhës së laktacionit dhe trajtimit të kafshëve për mish në bazën prodhuese të shkollës dhe ekonomi blegtorale, si dhe kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me trajtimin e kafshëve të qumështit dhe mishit.
- Instruktori duhet të përdorë tekste standarde dhe manuale që kanë të bëjnë me metodat e trajtimit të kafshëve në laktacion e majmëri.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune në fermën e shkollës dhe ambiente të tjera të përshtatshme për trajtimin e kafshëve në periudha të ndryshme të laktacionit e të majmërisë, llogaritjet e thjeshta ekonomike që lidhen me trajtimin e kafshëve të qumështit dhe mishit, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për njohuritë e marra për trajtimin e kafshëve të qumështit dhe të majmërisë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Baza prodhuese ose fermë për rritjen e kafshëve.
 - Pajisje dhe vegla pune për pastrimin e stallës dhe trupit të kafshëve.
 - Furça, sfungjerë, kashai, thika druri.
 - Peshqirë, pece, kova uji për higjienën e gjirit.
 - Aparat për mjelje mekanike.
 - Bidonë apo tank ftohës për ruajtjen e qumështit.
 - Tokë kullosore, magazinë ushqimi, depo silazhi.
 - Tabela analitike të ushqimeve.
 - Tabela për nevojat ushqimore të kafshëve.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Materiale studimore.
 - Video me demonstrime të ndryshme.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimet e murit me tulla (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal
-

4. Moduli: “Trajtimi i shpendëve për prodhim mishi e vezësh”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Prodhim shtazor
Niveli: II
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	TRAJTIMI I SHPENDËVE PËR PRODHIM MISHI E VEZËSH	M-28-556-11
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer procese pune për trajtimin e shpendëve për mish dhe vezë në kushtet e fermave të vogla, si dhe për të bërë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me trajtimin e shpendëve për prodhim mishi e vezësh.	
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”. të ketë përfunduar modulet “Kujdesi gjatë çeljes së zogjve” dhe “Kujdesi gjatë rritjes natyrale dhe artificiale të shpendëve”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi trajton shpendët për mish Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja dhe veshja e uniformës.– Përcaktimi i radhës së kryerjes së proceseve të punës.– Përzgjedhja e mjeteve dhe veglave të punës.– Përzgjedhja e ambientit të trajtimit të shpendëve për prodhim mishi.– Sigurimi i kushteve zoohigjenike të ambientit.– Seleksionimi i shpendëve për mish, sipas kondicionit.– Përzgjedhja e ushqimeve të shpendëve për mish.– Përllogaritja e sasisë së ushqimeve.– Hartimi i racioneve ushqimore.– Kontrolli i ushqimit dhe ujit.– Shpërndarja e racioneve ushqimore.– Sigurimi në vazhdimësi i ujit të pijshëm.– Nxjerrja e shpendëve në kullota natyrale.– Peshimi periodik i shpendëve.– Regjistrimi i të dhënave të duhura në kartelën përkatëse.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë trajtimit të shpendëve për mish Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Pyetje-përgjigje me gojë– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:	

-
- të përgatisë dhe të veshë uniformën para se të fillojë me kryerjen e proceseve të punës.
 - të përcaktojë siç duhet radhën e kryerjes së proceseve të punës për trajtimin e shpendëve për prodhim mishi.
 - të përzgjedhë mjetet, veglat dhe materialet e nevojshme të punës.
 - të përzgjedhë ambjentin për trajtimin e shpendve për mish, sipas numrit të krerëve.
 - të sigurojë kushtet zoohigjenike të ambientit për trajtimin e shpendëve për mish.
 - të seleksionojë shpendët për mish sipas kondicionit të tyre.
 - të përzgjedhë ushqimet e nevojshme për trajtimin e shpendëve për mish, sipas nevojave të grupmoshës dhe llojit të shpendëve.
 - të përlllogarisë sasinë e ushqimit për trajtimin e shpendëve për mish.
 - të hartojë racionet ushqimore sipas grupmoshës dhe llojeve të shpendve.
 - të kontrollojë ushqimet dhe ujin për cilësi dhe pastërti.
 - të shpërndajë racionet ushqimore, sipas orarit të paracaktuar.
 - të sigurojë në vazhdimësi ujë të pijshëm.
 - të nxjerrë shpendët në kullota natyrale.
 - të bëjë peshimin periodik të shpendëve për të përcaktuar dinamikën e shtesës së peshës.
 - të regjistrojë të dhënat për çdo shpend në kartelën përkatëse.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë trajtimit të shpendëve për mish.

RM 2 Nxënësi trajton shpendët për vezë.

Përmbajtja

- Përgatitja dhe veshja e uniformës.
- Përcaktimi i radhës së kryerjes së proceseve të punës.
- Përzgjedhja e mjeteve dhe veglave të punës
- Përzgjedhja e ambjentit të trajtimit të shpendve për vezë.
- Sigurimi i materialeve dhe ndërtimi i furriqeve.
- Sigurimi i kushteve zoohigjenike në ambjentet e trajtimit të shpendëve për vezë.
- Seleksionimi i shpendëve për vezë.
- Hartimi i racioneve ushqimore.
- Kontrolli i ushqimit dhe i ujit.
- Shpërndarja e racioneve ushqimore.
- Sigurimi në vazhdimësi i ujit të pijshëm.
- Mbledhja dhe grumbullimi i vezëve.
- Kontrolli i vezëve të grumbulluara.
- Vendosja e vezëve nëpër bigerina.
- Ruajtja e vezëve të prodhuara.

- Regjistrimi i të dhënave të duhura në kartelën përkatëse.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë trajtimit të shpendve për vezë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe të veshë uniformën para se të fillojë me kryerjen e proceseve të punës.
- të përcaktojë siç duhet radhën e kryerjes së proceseve të punës për trajtimin e shpendëve për prodhim vezësh.
- të përzgjedhë mjetet, veglat dhe materialet e nevojshme të punës për trajtimin e shpendëve për prodhim vezësh.
- të përzgjedhë ambientin për trajtimin e shpendve për vezë, sipas kriterëve të duhura.
- të sigurojë materialet dhe të ndërtojë furriqet e shpendëve
- të sigurojë kushtet zoohigjenike të ambientit ku do të trajtohen kafshët (temperature, lagështi, shtresë , dezenfektim).
- të seleksionojë shpendët për vezë sipas kondicionit të tyre.
- të përzgjedhë ushqimet në sasi, cilësi e llojshmëri për trajtimin e shpendëve për vezë.
- të hartojë racionet ushqimore sipas stinës dhe grup moshave të llojeve të shpendve.
- të kontrollojë ushqimet dhe ujin për cilësi dhe pastërti.
- të shpërndajë racionet ushqimore sipas vakteve të paracaktuara.
- të sigurojë në vazhdimësi ujë të pijshëm.
- të mbledhë dhe grumbullojë me shume kujdes vezët.
- të kontrollojë vezë e grumbulluara për dëmtime të ndryshme.
- të vendosë vezët nëpër bigerina sipas kërkesës.
- të ruajë vezët e prodhuara në mjediset e duhura.
- të regjistrojë të dhënat e kërkuara në kartelën përkatëse.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë trajtimit të shpendve për vezë

RM 3 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të trajtimit të shpendëve për prodhim mishi e vezësh.

Përmbajtja

- Kostot në trajtimin e shpendëve për prodhim mishi e vezësh, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël për trajtimin e shpendëve për mishi dhe vezë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot në trajtimin e shpendëve për prodhim mishi e vezësh, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport, amortizime dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritën të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për trajtimin e shpendëve për mish dhe vezë.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose tek fermerë që kanë në pronësi shpend.
- Mësuesi/instruktori mund të organizojë vizita mësimore në ferma të cilat mbarështojnë shpend për mish e vezë në kushte natyrore e artificiale, ku nxënësit të vëzhgojnë në mënyrë konkrete proceset e punës që kryehen për trajtimin e shpendëve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për trajtimin e shpendve për mish dhe vezë, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me trajtimin e shpendëve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për trajtimin e shpendve për mish dhe vezë, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me trajtimin e shpendëve.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me trajtimin e shpendve për mish dhe vezë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të theksohet verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për trajtimin e shpendve për mish dhe vezë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Lokale shpendësh
 - Tabela e vlerave ushqimore të ushqimeve të llojeve të ndryshme
 - Ushqime të ndryshme si misër, grurë, sorgum, hime, ermik, bërsisoje.
 - Ushqime shtazore si miell peshku, miell gjaku, premikse.
 - Kullota natyrore (njomishte), pirëse uji, kova, dezenfektantë, fshesa, lopata etj.
 - Magazinë ushqimi dhe për ruajtjen e vezëve.
 - Tabela analitike të ushqimeve.
 - Tabela për nevojat ushqimore të shpendëve.
-

-
- Mjete të tjera vizuale.
 - Materiale studimore.
 - Video me demonstrime të ndryshme.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimet e murit me tulla (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal
-

5. Moduli “Kujdesi gjatë rritjes artificiale të peshkut”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Prodhim shtazor
Niveli: II
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KUJDESI GJATË RRRITJES ARTIFICIALE TË PESHKUT	(M-28-562-12)
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për të vlerësuar parametrat e baseneve të rritjes së peshkut, si dhe për tu kujdesur për to në basene, si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të rritjes artificiale të peshkut.	
Kohëzgjatja e modulit	66 orë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Nxënësi vlerëson parametrat e basenit të rritjes artificiale të peshkut Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja dhe veshja e uniformës.– Përzgjedhja e mjeteve, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme të punës.– Vlerësimi i përmasave të basenit.– Kontrolli për ujëkëmbim të qëndrueshëm në basen.– Vlerësimi i pastërtisë së ujit të basenit.– Kontrolli i temperaturës së ujit të basenit.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për vlerësimin e parametrave të basenit të rritjes së peshkut. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.– Pyetje përgjigje me gojë Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të tregojë kujdes për veshjen e uniformës.– të përzgjedhë mjetet, pajisjet dhe materialet e nevojshme të punës.– të kontrollojë ujëkëmbimin e basenit sipas standardit të duhur.– të vlerësojë pastërtinë e ujit të basenit, sipas standardit të duhur– të kontrollojë temperaturën e ujit, sipas standardit të duhur.

-
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për vlerësimin e parametrave të basenit të rritjes së peshkut.

RM 2 Nxënësi kujdeset për peshqit në basenin e rritjes artificiale.

Përmbajtja

- Përgatitja dhe veshja e uniformës.
- Përgatitja e mjeteve dhe pajisjeve për hedhjen e ushqimit.
- Përcaktimi i llojit dhe sasisë së peshqve që do të rritet në basen.
- Blerja e rasatit të peshkut.
- Sigurimi i bazës materiale për rritjen artificiale të peshkut.
- Përzgjedhja e ushqimit për peshqit që rriten në basenë artificiale
- Trajtimi i peshqve me substanca shtesë (multivitamina).
- Hartimi i racionit ushqimor sipas fazave të rritjes së peshkut.
- Kontrolli paraprak organoleptik i ushqimit.
- Transporti i ushqimit nga depoja për në basen.
- Hedhja e ushqimit të racionuar.
- Mbikëqyrja e gjendjes së peshqve në basen.
- Veçimi i peshqve të sëmurë apo të dëmtuar.
- Sigurimi i një sistemi të rregullt temperature, uji e ndriçimi gjatë 24 orëve.
- Kapja dhe nxjerrja e peshqve të rritur nga baseni.
- Standardizimi i peshqve.
- Larja dhe pastrimi i peshqve.
- Paketimi i peshqve për treg.
- Magazinimi i peshqve të prodhuar.
- Pastrimi i vendit dhe i mjeteve të punës.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe etikë profesionale.
- Kryerja e shpërndarjes apo marketingut të produktit në treg, ose konsumimi i tij vetjak.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesit për peshqit në basenin e rritjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pytje përgjigje me gojë

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur për kryerjen e shërbimeve në basen.
- të përgatitë mjetet dhe pajisjet për hedhjen e ushqimit në basen.
- të përcaktojë llojin dhe sasinë e peshqve që do të rritet në basen, sipas madhësisë së basenit.
- të blejë sasinë e duhur të rasatit të peshkut me kosto

- efektive.
- të sigurojë bazën materiale të domosdoshme për rritjen artificiale të peshkut.
 - të përzgjedhë ushqimin e duhur për peshqit që rriten në basenë artificiale
 - të trajtojë peshqit me substanca shtesë (multivitamina).
 - të hartojë racionin ushqimor sipas fazave të rritjes së peshqve.
 - të kryejë me kujdes kontrollin organoleptik të ushqimit.
 - të transportojë ushqimin nga depoja për në basen.
 - të hedhë ushqimin e racionuar në kohën e duhur.
 - të mbikëqyrë vazhdimisht gjendjen e peshqve në basen.
 - të veçojë, kur është e nevojshme. peshqit e sëmurë apo të dëmtuar nga baseni.
 - të sigurojë një sistemi të rregullt temperature, uji e ndriçimi gjatë 24 orëve, sipas standardit të kërkuar.
 - të kryejë kapjen dhe nxjerrjen e peshqve të rritur nga baseni.
 - të realizojë standardizimin e peshqve.
 - të lajë e pastrojë me shumë kujdes peshqit.
 - të paketojë peshqit sipas kërkesës së klientit.
 - të magazinonjë sasinë e peshqve të prodhuar.
 - të pastrojë vendin dhe mjetet e punës pas larjes dhe pastrimit të peshqve.
 - të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale me klientin.
 - të plotësojë faturën e shërbimit të kryer.
 - të kryejë shpërndarjen apo marketingun e produktit në treg, ose konsumimin i tij vetjak.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesit të peshqve në basen.

RM 3 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të rritjes artificiale të peshkut.

Përmbajtja

- Kostot në punët e rritjes së peshkut në kushte artificiale, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël për rritjen artificiale të peshkut.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot në rritjen artificiale të peshkut, si dhe

- përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport, amortizime dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për rritjen artificiale të peshkut.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e rritjes artificiale të peshkut.
- Instruktori i praktikës duhet të drejtojë nxënësit në vlerësimin e parametrave të basenit të rritjes artificiale të peshkut
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kontrollin e përmasave të baseneve, ujëkëmbimit, pastërtisë së ujit, temperaturës së ujit, përzgjedhjen e ushqimit dhe kontrollin organoleptik të tij, për hartimin e racionit ushqimor sipas fazave të rritjes së peshkut, për transportin e ushqimit, hedhjen e racionuar të tij, si dhe në llogaritjet e thjeshta ekonomike që lidhen me to.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me rritjen artificiale të peshkut.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të theksohet verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për rritjen artificiale të peshkut.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Ekonomi të rritjes artificiale të peshkut.
 - Basene dhe motopompa për ujëkëmbim.
 - Peshq në faza të ndryshme rritjeje, rasate peshku.
 - Metër, termometër, enë për kontrollin e ujit.
 - Ushqim proteinik i granular.
 - Enë për hedhjen e ushqimit.
 - Ujë i sapunuar ose mishele nafte me vaj makinash.
 - Garza, pambuk, peshqirë.
 - Pajisje për kapjen e peshkut (rrjeta, kosha, etj).
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e koston.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimet e murit me tulla (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal
-

6. Moduli: “Qethja e dheneve”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Prodhim shtazor
Niveli: II
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhen kod	QETHJA E DHENVE	M-28-558-11
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të zbatuar teknikat e qethjes së dheneve me gërsherë dore e makinë qethëse, bërë vlerësimin e cilësisë së produktit, si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me qethjen e dheneve.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen punë përgatitore për qethjen e dheneve Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja dhe veshja e uniformës.– Përcaktimi i mjedisit të qethjes.– Përcaktimi i kohës së qethjes.– Përzgjedhja e shtresës.– Përzgjedhja e mjeteve të qethjes.– Përgatitja për punë e mjeteve të qethjes– Sigurimi i medikamenteve në raste lëndimi të dheneve gjatë qethjes.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë përgatitjes së kushteve për qethjen e dheneve. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të tregojë kujdes për veshjen e uniformës.– të përcaktojë mjedisin e qethjes, sipas parametrave të duhura.– të përzgjedhë saktë mjetet e nevojshme të qethjes së dheneve.– të përgatisë për punë mjetet e qethjes së dheneve.– të sigurojë medikamentet e nevojshme për mjekime të çastit, në rast nevoje.– të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së kushteve për qethjen e dheneve.	

RM 2 Nxënësi qeth dhent me gërshëre dore.

Përmbajtja

- Përgatitja dhe veshja e uniformës.
- Vendosja e mjeteve të punës pranë mjedisit të qethjes.
- Kontrolli i gjendjes së përgjithshme të kafshës.
- Kontrolli i lëkurës për sëmundje të ndryshme.
- Fiksimi i dhenve për qethje.
- Qethja e dhenve në mënyrë uniforme.
- Mjekimi në raste lëndimesh gjatë qethjes.
- Mprehja herë pas here e gërshërëve gjatë qethjes.
- Pastrimi i gërshërëve pas qethjes.
- Peshimi i sasisë së leshit pas qethjes.
- Regjistrimi i të dhënave në kartelë.
- Grumbullimi i leshit të dhenve në vendin e duhur.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i vendit pas përfundimit të qethjes së dhenve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë qethjes së dhenve me gërshërë dore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur për qethjen e dhenve.
- të vendosë mjetet e punës pranë mjedisit të qethjes.
- të kontrollojë me kujdes gjendjen e përgjithshme të dhenve.
- të kontrollojë me kujdes lëkurën për sëmundje të ndryshme.
- të fiksojë dhentë në pozicionin e duhur për qethje.
- të qethë dhentë në mënyrë uniforme me gërshërë dore.
- të bëjë mjekimin në raste lëndimesh gjatë qethjes së dhenve.
- të mprehë gërshërët me kujdes para dhe gjatë qethjes.
- të pastrojë gërshërët pas qethjes dhe t'i dezinfektojë ato.
- të peshojë me saktësi sasisë e leshit pas qethjes, sipas krerëve.
- të regjistrojë saktë të dhënat në kartelën përkatëse.
- të grumbullojë sasinë e leshit të dhenve në vendin e duhur.
- të pastrojë e dezinfektojë vendin pas përfundimit të qethjes së dhenve.
- të zbatojë me korrektësi rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë qethjes së dhenve me gërshërë dore.

RM 3 Nxënësi qeth dhent me makinë qethëse.

Përmbajtja

- Përgatitja dhe veshja e uniformës.

- Vendosja e dhenve mbi një pod dërrase.
- Kontrolli i gjendjes së përgjithshme të dhenve.
- Kontrolli i lëkurës për sëmundje të ndryshme.
- Vendosja e mjeteve të punës pranë mjedisit të qethjes.
- Kontrolli dhe përgatitja e makinës qethëse për punë.
- Sigurimi i tokëzimit të makinës qethëse.
- Fiksimi i dhenve në pozicionin për qethje.
- Qethja e dhenve në mënyrë uniforme.
- Mjekimi në raste lëndimesh gjatë qethjes.
- Ftohja e makinës qethëse gjatë qethjes.
- Pastrimi i makinës qethëse pas përfundimit të qethjes.
- Peshimi i sasisë së leshit pas qethjes.
- Regjistrimi i të dhënave.
- Grumbullimi i leshit të dhenve në vendin e duhur.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i vendit pas përfundimit të qethjes së dhenve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë qethjes së dhenve me makinë qethëse

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur për qethjen e dhenve.
- të vendosë dhentë mbi një pod dërrase.
- të kontrollojë me kujdes gjendjen e përgjithshme të dhenve.
- të kontrollojë me kujdes lëkurën për sëmundje të ndryshme.
- të vendosë mjetet e punës pranë mjedisit të qethjes.
- të kontrollojë dhe përgatisë makinën qethëse për punë.
- të sigurojë tokëzimin e makinës qethëse.
- të fiksojë dhentë në pozicionin e duhur për qethje.
- të qethë dhentë në mënyrë uniforme me gërsërë dore.
- të bëjë mjekimin në raste lëndimesh gjatë qethjes së dhenve.
- të qethë dhentë në mënyrë uniforme.
- të bëjë mjekimin e çastit në raste lëndimesh gjatë qethjes.
- të ftohë makinën qethëse gjatë procesit të qethjes
- të pastrojë makinën qethëse pas përfundimit të qethjes.
- të peshojë me saktësi sasisë e leshit pas qethjes, sipas krerëve.
- të regjistrojë saktë të dhënat në kartelën përkatëse.
- të grumbullojë sasinë e leshit të dhenve në vendin e duhur.
- të pastrojë e dezinfektojë vendin pas përfundimit të qethjes së dhenve.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë qethjes së dhenve me makinë qethëse.

RM 4 Nxënësi bën vlerësimin e produktit (lesh)

Përmbajtja

- Përgatitja dhe veshja e uniformës.
- Vendosja e produktit (leshit) mbi tavolinën e klasifikimit.
- Largimi i papastërtive nga produkti.
- Ndarja e bashkës nga të përvjelat.
- Vlerësimi (klasifikimi) i cilësisë së leshit.
- Mbështjellja e bashkës.
- Paketimi i produktit.
- Llogaritja e kostos në qethjen e dhenve, si dhe përbërësit e kostove.
- Hartimi i preventivit të materialeve, kostoja për materialet.
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Komunikimi me etikë e profesionalizëm.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë vlerësimit dhe paketimit të produktit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur për qethjen e dhenve.
- të vendosë produktin mbi tavolinën e klasifikimit.
- të largojë papastërtitë nga produkti.
- të ndajë bashkën nga të përvjelat.
- të vlerësojë leshin ose produktin sipas cilësisë.
- të mbështjellë siç duhet bashkën.
- të paketojë siç duhet produktin (leshin).
- të llogaritë kostot në qethjen e dhenve, si dhe përbërësit e kostove.
- të bëjë preventivin e materialeve, koston për materialet.
- të llogaritë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- të komunikojë me etikë e profesionalizëm.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë vlerësimit dhe paketimit të produktit përfundimtar.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës nëse ka dhen, ose në ferma private të cilat mbarështojnë dhen.
- Mësuesi/instruktori mund të organizojë edhe vizita mësimorë në ferma blegtorale ku mbarështohen dhen, për të vëzhguar nga afër teknikat e qethjes së dhenve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për qethjen me gërshërë dore e me makinë qethëse, si dhe për vlerësimin e produktit sipas standardit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për qethjen me gërshërë dorë e atë mekanike fillimisht duke u

mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.

- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me qethjen me gërshërë dore e atë mekanike, si dhe për cilësinë e produktit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të theksohet verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për qethjen e dhenve me gërshërë dhe makinë qethëse.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Baza prodhuese ose fermë dhensh
 - Pajisje e vegla për qethjen e dhenve
 - Gërshërë dhe makina qethëse.
 - Pode dërrase.
 - Mjete për mprehjen e gërshërëve.
 - Ujë i sapunuar ose mishele nafte me vaj makinash.
 - Dezinfektant.
 - Garza, pambuk, peshqirë, sapunë, kova uji.
 - Plasmasë dhe thasë ambalazhimi.
 - Pajisje kancelarie, kartela.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimet e murit me tulla (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal
-

7. Moduli: “Kujdesi për rritjen e mbarështimin e kafshëve të punës”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Prodhim shtazor
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KUJDESI PËR RITJEN E MBARËSHTIMIN E KAFSHËVE TË PUNËS	(M-28-559-12)
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer pastrimin e mjedisit të mbajtjes së kafshëve të punës, lëkurës së trupit, për prerjen e thundrave, të ushqyerit e tyre, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me rritjen e mbarështimin e kafshëve të punës.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi pastron vendqëndrimin e kafshëve të punës.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja dhe veshja e uniformës.– Largimi i kafshëve nga stalla dhe territori jashtë saj.– Përzgjedhja dhe përgatitja e veglave të punës dhe llojit të dezinfektantit që do përdoret.– Pastrimi i stallës nga plehu dhe mbeturinat ushqimore.– Transportimi i plehut në plehërishte.– Larja dhe dezinfektimi i stallës.– Vendosja e shtresës për kafshët.– Pastrimi i veglave e pajisjeve pas punës.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë pastrimit të stallës së kafshëve. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.– Pyetje-përgjigje me gojë. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– Të veshë uniformën për të kryer pastrimin e mjedisit të kafshëve të punës.– Të largojë kafshët nga stalla dhe territori përreth.– Të përzgjedhë dhe të përgatitë siç duhet mjetet që nevojiten për pastrimin, larjen dhe dezinfektimin e stallës të kafshëve të punës.– Të pastrojë stallën nga plehu dhe mbeturinat ushqimore.– Të transportojë plehun në kohën e duhur për në	

plehërishte.

- Të bëjë larjen e dezinfektimin e stallës.
- Të vendosë shtresën për kafshët e punës.
- Të pastrojë e të mirëmbajë veglat e pajisjet e punës.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë gjatë pastrimit të stallës së kafshëve të punës.

RM 2 Nxënësi pastron trupin e kafshëve të punës.

Përmbajtja

- Veshja e uniformës për pastrimin e lëkurës së trupit të kafshëve të punës.
- Përzgjedhja dhe përgatitja e mjeteve dhe pajisjeve që përdoren për pastrimin e trupit të kafshëve të punës.
- Përcaktimi i radhës së punës për pastrimin e trupit të kafshëve të punës.
- Përcaktimi i llojit të kafshëve të punës për pastrim.
- Fiksimi i kafshëve të punës për pastrim.
- Pastrimi i trupit të kafshëve.
- Largimi i mbeturinave gjatë dhe pas pastrimit të trupit të kafshëve të punës.
- Larja e mirëmbajtja e veglave dhe pajisjeve.
- Larja e dezinfektimi i duarve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë pastrimit të trupit të kafshëve të punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- Të veshë kompletin e punës: kominoshe, përparëse bezeje, përparëse plasmasi, kapuç, dorashka llastiku, çizme.
- Të përzgjedhë saktë mjetet e punës për pastrimin e trupit të kafshëve.
- Të përcaktojë radhën e punës për pastrimin e trupit të kafshëve të punës.
- Të përzgjedhë llojin e kafshëve të punës për pastrim: kuaj, mushka, gomerë, qe pune.
- Të realizojë fiksimin e kafshëve të punës për pastrim.
- Të bëjë pastrimin e trupit të kafshëve të punës nga papastërtitë.
- Të largojë mbeturinat gjatë pastrimit të trupit të kafshëve të punës.
- Të pastrojë veglat dhe pajisjet që përdoren për pastrimin e trupit të kafshëve të punës.
- Të bëjë larjen e duarve pas operacioneve të kryera.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punës së pastrimit të trupit të kafshëve të punës.

RM 3 Nxënësi pastron dhe pret thundrat e kafshëve të punës.

Përmbajtja

- Përzgjedhja e përgatitja veglave, materialeve dhe e uniformës për pastrimin dhe prerjen e thundrave të kafshëve të punës.
- Caktimi i vendit për pastrimin dhe prerjen e thundrave të kafshëve të punës.
- Përcaktimi i kafshës për pastrimin dhe prerjen e thundrave.
- Afrimi i mjeteve të punës pranë kafshës.
- Fiksimi i kafshës.
- Pastrimi i tabanit (shollit).
- Larja e tabanit të kafshës.
- Tharja e tabanit të kafshës.
- Prerja e thoit të rritur.
- Rrafshimi i thoit.
- Mirëmbajtja e pajisjeve dhe e veglave të tjera të punës.
- Pastrimi i vendit të punës dhe mjedisit nga mbeturinat.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë pastrimit dhe prerjes së thundrave të kafshëve të punës.

Instrumentet e vlerësimit

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të veshë kompletin e punës, kominoshe, çisme, etj
- Të caktojë vendin e posaçëm për pastrim dhe prerje të thundrave të kafshëve të punës.
- Të përcaktojë kafshën për pastrim dhe prerje të thundrave.
- Të vendosë mjetet e nevojshme të punës pranë kafshës.
- Të fiksojë kafshën në pozicionin e duhur për pastrimin dhe prerjen e thundrave.
- Të pastrojë tabanin e thundrës së kafshës me ane të thikës prej druri.
- Të kryejë larjen me ujë të pastër të tabanit të thundrës së kafshës.
- Të thajë me pece të thatë tabanin e thundrës së kafshës.
- Të kryejë prerjen e thoit të rritur me anë të prerëses së thundrave.
- Të kryejë rrafshimin e thoit, me limë.
- Të vendosë në vendin e duhur, veglat e punës, pas pastrimit dhe prerjes së thundrave të kafshës.
- Të mbajë pastër vendin e punës dhe mjedisin nga mbeturinat që përftohen gjatë pastrimit dhe prerjes së thundrave të kafshës.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë pastrimit dhe prerjes së thundrave të kafshëve të punës.

RM 4 Nxënësi ushqen kafshët e punës.

Përmbajtja

- Përzgjedhja dhe përgatitja veglave dhe materialeve dhe e uniformës për të ushqyer kafshët e punës.
- Sigurimi i bazës së nevojshme ushqimore për kafshët e punës.
 - Përzgjedhja e llojit të ushqimit.
 - Konsultimi me tabelën e vlerave ushqyese të ushqimeve.
 - Racionimi i ushqimit.
 - Kontrolli paraprak organoleptik i ushqimit.
 - Pastrimi i grazhdit për hedhjen e ushqimit.
 - Transportimi i ushqimeve në stallë.
 - Hedhja e ushqimit të normuar në grazhd.
 - Dhënia e ujit.
 - Pastrimi i vendit dhe largimi i mbeturinave.
 - Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
 - Regjistrimi i të dhënave të duhura në kartelën përkatëse.
 - Llogaritja e kostos në rritjen e mbarështimit të kafshëve të punës, si dhe përbërësit e kostove.
 - Hartimi i preventivit të materialeve, kostoja për materialet.
 - Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
 - Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
 - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë të ushqyerit të kuajve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë dhe përgatitë siç duhet, veglat, materialet, si dhe uniformën të domosdoshme për të ushqyer kafshët e punës.
- të sigurojë bazën ushqimore të nevojshme për kafshët bazuar në numrin dhe llojin e tyre.
- Të përzgjedhë llojin e ushqimeve (të njoma, të thata, të koncentruara), sipas punës, llojit dhe moshës së kafshëve.
- të konsultohet me tabelën e vlerave ushqyese të ushqimeve.
- të bëjë racionimin e ushqimit për krerë sipas llojit, moshës dhe punës që kryejnë kafshët.
- të bëjë përpunimin e ushqimeve për kafshët e punës në varësi të llojit të ushqimit.
- të bëjë pastrimin e grazhdit përpara hedhjes së ushqimit.
- të transportojë ushqimet në stallë, me mjetet e nevojshme.
- të shpërndajë ushqimin e normuar në grazhd.
- të shpërndajë ujin për kafshët, në sasinë e nevojshme.
- të pastrojë vendin dhe të largojë mbeturinat nga vendqëndrimi i kafshëve.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës pas operacioneve të ushqyerit të kafshëve të punës.
- të regjistrojë saktë të gjitha të dhënat në kartelën përkatëse.

- të llogaritë kostot në rritjen e mbarështimit të kafshëve të punës, si dhe përbërësit e kostove.
- të bëjë preventivin e materialeve, koston për materialet.
- të llogaritë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve të punës për ushqyerjen e kafshëve të punës.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul mund të trajtohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës ose në territoret jashtë saj.
- Mësuesi instruktori mund të organizojë edhe vizita mësimorë në ferma blegtorale ku mbarështohen kafshë pune, për të vëzhguar nga afër shërbimet që kryhen për kujdesin ndaj tyre.
- Nxënësit duhet të përfshihen në të gjitha aspektet e kujdesit të kafshëve të punës, që përfshin: përgatitjen e mjeteve dhe uniformës, në kryerjen e pastrimit të stallës, pastrimit të trupit, pastrimit e prerjen e thundrave, mirëmbajtjen e mjeteve e materialeve, ushqyerjen e kafshëve, zbatimin e rregullave të sigurisë në punë e të ruajtjes së mjedisit, si dhe në kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për rritjen dhe mbarështimin e kafshëve të punës.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë demonstrimet praktike për përgatitjen e mjeteve e uniformës, kryerjen e pastrimit të stallës, pastrimit të trupit, pastrimit e prerjen e thundrave, mirëmbajtjen e mjeteve e materialeve, ushqyerjen e kafshëve, llogaritjet e thjeshta ekonomike, si dhe zbatimin e rregullave të sigurisë në punë e të ruajtjes së mjedisit gjatë rritjes dhe mbarështimit të kafshëve të punës.
- Nxënësit praktikohen në këto procese pune, fillimisht të mbikqyrur nga instruktori apo specialisti përkatës, pastaj në mënyrë të pavarur.
- Instruktori/mësuesi duhet të përdorë mjete vizuale apo edhe pamje filmike (kur është e mundur) të proceseve të punës që kryhen gjatë rritjes dhe mbarështimit të kafshëve të punës, si dhe duhet të përdorë tabela me vlerat ushqyese të ushqimeve të ndryshme që përdoren për kafshët e punës.
- Realizimi i pranuehëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqëshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Baza prodhuese e shkollës.
 - Fermë e mbarështimit të kafshëve të punës.
 - Komplet i veshjes.
 - Paisje e vegla të nevojshme pune për pastrimin e stallës si dhe të trupit e thundrave të kafshëve.
-

-
- Lecka, kova me ujë, peshqirë, krehër druri, thika druri, thika të thundrave, pomadë zbutëse, prerëse e thundrave, limë, kashai.
 - Mjete për largimin e plehut si: lopata, sfurqe, karroca dore.
 - Fotografi me pamje të punëve të ndryshme gjatë pastrimit të trupit dhe prerjes së thundrave dhe ushqyerjes së kafshëve të punës.
 - Tabela analitike të ushqimeve.
 - Manuale praktike për të ushqyerit e kafshëve të punës.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manuallet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimet e murit me tulla (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Kujdesi për riprodhimin e lopëve”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Prodhim shtazor
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	KUJDESI PËR RIPRODHIMIN E LOPËVE	(M-28-557-12)
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të zbuluar shenjat e afshit në lopë të ndryshme, kryerjen e shërbimeve gjatë riprodhimit, kujdesin gjatë mbarsmërisë, pjelljes, si dhe kujdesin pas pjelljes dhe për të porsalindurit.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi zbulon shenjat e afshit në lopë. Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">– Veshja e uniformës.– Përcaktimi i planit të punës.– Identifikimi i lopëve në afsh.– Vrojtimet e shpeshta në lopë.– Mbajtja e shënimeve gjatë vrojtimit.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë vrojtimit të lopëve e deleve në afsh Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– Të veshë uniformën e duhur.– Të përcaktojë siç duhet planin e punës për zbulimin e shenjave të afshit te lopët.– Të përcaktojë lopët në afsh, për vrojtim.– Të mbajë saktë shënimet për lopët e delet e vrojtuar.– Të identifikojë lopët me shenja afshi (ulje oreksi, pëllitje të shpeshta, lëvizje të shumta, shikim të përqendruar, ënjtje dhe skuqje e vulvës, rrjedhje mukusi, ngritje bishti, kërcime mbi kafshët e tjera.)– Të mbahen saktë shënimet për çdo vrojtim.– Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë kontrollit të	

RM 2 Nxënësi kujeset për lopët gjatë mbarsmërisë.

Përmbajtja

- Përgatitja dhe veshja e uniformës.
- Përzgjedhja e mjeteve dhe veglave për kujdesin e lopëve barse.
- Sigurimi i higjenës së stallës.
- Pastrimi i vendit të hedhjes së ushqimit e ujit të pijshëm.
- Pastrimi i trupit të kafshës.
- Përzgjedhja dhe racionimi i ushqimeve.
- Kontrolli organoleptik i ushqimeve.
- Sigurimi i ujit të pijshëm.
- Nxjertja e lopëve për lëvizje (mocion).
- Vendosja në ambiente të caktuara e lopëve në tharje.
- Regjistrimi i të dhënave të duhura të lopëve barse.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesit për lopët barse.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përzgjedhë mjetet e nevojshme të punës për kujdesin e lopëve barse.
- Të sigurojë mbajtjen e higjenës në stallë nëpërmjet pastrimit dhe dezinfektimit të saj.
- Të pastrojë grazhdet e ushqimit dhe lugjet e ujit.
- Të pastrojë trupin e kafshës.
- Të përzgjedhë dhe të racionojë ushqimet për lopët sipas periudhave të ndryshme të mbarsmërisë.
- Të kontrollojë ushqimet për pastërti, myk, kalbje, të ngrira, metale etj.
- Të sigurojë ujin e pijshëm, të pastër e të bollshëm.
- Të nxjerrë lopët për lëvizje (mocion).
- Të vendosë lopët në periudhën e tharjes në ambiente të caktuara.
- Të regjistrojë të dhënat e duhura në kartelën përkatëse.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesit për lopët gjatë mbarsmërisë.

RM 3 Nxënësi kujdeset për lopën në prag të pjelljes.

Përmbajtja

- Përzgjedhja dhe përgatitja e uniformës, veglave dhe materialeve ndihmëse për përgatitjen e vendit dhe të kafshës për pjellje.
- Përcaktimi i ambientit të pjelljes.
- Përgatitja e vendit të pjelljes.
- Përgatitja e kafshës për pjellje

- Regjistrimi i të dhënave të lopës në prag të pjelljes.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesit për lopët në prag të pjelljes

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë siç duhet dhe të veshë patjetër uniformën: bluzë, kapuç, dorëza.
- të sigurojë mjetet e nevojshme të punës si: kovë, ujë, sapun, litarë, dezinfektant, pambuk, peshqirë etj.
- të përcaktojë ambjentin e pjelljes sipas kriterëve të duhura: vend i qetë, pa lëvizje, i pastër, i ajrosur, i ngrohtë.
- të përgatisë sipas parametrave të duhura vendin e pjelljes: pastrimi, dezenfektimi, vendosje e shtresës së bollëshme.
- të përgatisë siç duhet kafshën për pjellje: larje e pjesëve të pasme të trupit me ujë të ngrohtë e sapun, lyerje e organeve gjinorë të jashtme me dezinfektantë.
- të regjistrojë të dhënat e duhura të çdo lope në kartelën përkatëse.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes të mjedisit gjatë kujdesit për lopën në prag të pjelljes

RM 4 Nxënësi ndihmon kafshën gjatë pjelljes dhe të porsalindurin.

Përmbajtja

- Ndjekja e fazave të procesit të pjelljes.
- Tërheqja e frytit.
- Lidhja e kërthizës.
- Këputja e kërthizës.
- Dezinfektimi i kërthizës
- Kujdesi për të porsalindurin
- Kontrolli për nxjerrjen e placentës (shtratit).
- Pastrimi i mjedisit dhe vendosja e shtresës.
- Regjistrimi i të dhënave të pjelljes.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë pjelljes së kafshës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndjekë me vëmendje fazat e procesit të pjelljes: fazën përgatitorë dhe të nxjerrjes së frytit.
- të qëndrojë pranë specialistit për ta ndihmuar atë në tërheqjen e frytit: gjymtyrët e para ose të pasme tërhiqen në momentin e shtërzimit.
- të ndihmojë specialistin veterinar në lidhjen e kërthizës 8-10 cm larg nga lëkura e barkut të porsalinduri.
- të ndihmojë specialistin veterinar në këputjen/prerjen 2-3 cm larg vëndit të lidhjes të porsalinduri.

- të ndihmojë specialistin veterinar në dezinfektimin e kërthizës të porsalinduri.
- të kontrollojë nxjerrjen e placentës të kafsha pas pjelljes.
- të pastrojë mjedisin duke e pudrosur me pluhur gëlqereje dhe duke shtruar shtresë të thatë.
- të regjistrojë të dhënat e duhura në kartelën përkatëse.
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë pjelljes së kafshës.

RM 5 Nxënësi kujdeset për kafshën pas pjelljes

Përmbajtja

- Pastrimi dhe dezinfektimi i vendëndrrimit të kafshës pas pjelljes.
- Dhënia e ujit të ngrohtë lopës së sapopjellë.
- Përcaktimi i të ushqyerit të kafshës së sapopjellë.
- Vendosja në lëvizje e kafshës.
- Zbatimi i rregullave të mjeljes së kafshës.
- Regjistrimi i të dhënave në kartelë.
- Llogaritja e kostos në kujdesin për riprodhimin e lopëve, si dhe përbërësit e kostove.
- Hartimi i preventivit të materialeve, kostoja për materialet.
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesit për kafshën pas pjelljes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje - përgjigje.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të bëjë pastrimin dhe dezinfektimin e vendqëndrimit të kafshës pas pjelljes.
- të japë ujë të ngrohtë menjëherë pas lëpirjes së të porsalindurit: ujë të ngrohtë 37-38 °C + kripë gjelle.
- të përcaktojë mënyrën e të ushqyerit sipas gjendjes shëndetësore
- të vendosë në lëvizje 1-2 orë në ditë kafshën.
- të zbatojë rregullat e mjeljes së lopëve 4-5 herë në ditë.
- të regjistrojë të dhënat e duhura në kartelën përkatëse.
- të llogaritë kostot në kujdesin për riprodhimin e lopëve, si dhe përbërësit e kostove.
- të bëjë preventivin e materialeve, koston për materialet.
- të llogaritë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesit për kafshën gjatë pjelljes.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë shkollës ose në ferma blegtorale me lopë,

dhe për vlerësimin e nxënësve.

- dele apo derra.
- Instruktori mund të organizojë vizita mësimorë në komplekse blegtorale duke iu dhënë mundësi nxënësve për të vrojtur konkretisht disa nga shenjat e afshit në kafshë të ndryshme.
 - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për të kryer vrojtme për zbulimin dhe përcaktimin e shenjave të afshit te kafshët, vetëm në mbikqyrje të instruktorit apo specialistit veterinar.
 - Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me shenjat e afshit te kafshët.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e përcaktimit të shenjave të afshit në kafshë të ndryshme.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Baza prodhuese ose fermë blegtorale
 - Kafshë në afsh
 - Dëshë të provës
 - Harça të provës
 - Dokumentacion për mbajtjen e shënimeve.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Vidio me demonstrime të ndryshme.
 - Kartela
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimet e murit me tulla (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal
-

2. Moduli “Kujdesi gjatë rritjes së shpendëve dekorativ”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Prodhim shtazor
Niveli: II
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	KUJDESI GJATË RRRITJES SË SHPENDËVE DEKORATIV	(M-28-560-11)
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për t’u kujdesur për mbarështimin dhe të ushqyerit e zogjve dekorativë në kushte shtëpie, si dhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike gjatë rritjes së shpendëve dekorativ.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kujdeset për mbarështimin e pëllumbave Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja dhe veshja e uniformës së punës.– Përcaktimi i proceseve të punës që kryhen për ndërtimin e kafazit të pëllumbave.– Përzgjedhja e mjeteve, pajisjeve dhe materialeve për mbarështimin e pëllumbave.– Llogaritja e madhësisë së kafazit.– Ndërtimi i kafazit të pëllumbave.– Zgjedhja e ambientit ku do të vendoset kafazi.– Përzgjedhja e racës së pëllumbave.– Mbikqyrja e çiftëzimit të pëllumbave.– Kontrolli i pjelljes e vezëve.– Kujdesi për zogjtë e sapoçelur.– Kujdesi për rritjen e pëllumbave gjatë gjithë vitit.– Përcaktimi i shërbimeve që kryhen në kushte të përshtatshme higjienike dhe klimatike në kafaz.– Vendosja e tasave të baltës me kashtë dhe me pluhur dezinfektues.– Përzgjedhja e mjeteve për pastrimin e kafazit të pëllumbave.– Pastrimi i kafazit të pëllumbave.– Zbatimi i masave profilaktike dhe mjekuese në tufën e pëllumbave.– Mbajtja e shënimeve përkatëse për shërbimet dhe operacionet që kryhen gjatë kujdesit të mbarështimit të	

pëllumbave.

- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesit për mbarështimin e pëllumbave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë dhe të veshë uniformën e punës për ndërtimin e kafazit të pëllumbave.
- Të përcaktojë siç duhet proceset e punës ër ndërtimin e kafazit të pëllumbave për ndërtimin e kafazit të pëllumbave.
- Të përzgjedhë mjetet, pajisjet dhe materialet për mbarështimin e pëllumbave.
- Të llogaritë siç duhet madhësinë e kafazit të pëllumbave.
- Të ndërtojë kafazin për çiftin e pëllumbave sipas standardit.
- Të zgjedhë ambientin e duhur për vendosjen e kafazit: papafingo, oborr, etj.
- Të përzgjedhë racën e pëllumbave që do të mbarështojë.
- Të mbikqyrë çiftëzimin e pëllumbave në periudha të caktuara të vitit.
- Të kontrollojë procesin e pjelljes së vezëve 5-6 pjellje në vit .
- Të kujdeset për rritjen e zogjve të sapoçelur të pëllumbave.
- Të kryejë shërbime klimatike në kafaz si sigurimi i dritës natyrale, i ajrimit, i temperaturës sidomos në papafingo.
- Të vendosë në kafaz tasa balte me kashtë dhe me pluhur dezinfektues për morrat, pleshtat, etj.
- Të përzgjedhë mjetet që nevojiten për pastrimin e kafazit.
- Të pastrojë kafazin nga jashtëqitjet e pëllumbave dhe mbeturinat ushqimore.
- Të zbatojë masat profilaktike duke përdorur vaksinat si tek shpendët.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit në punë gjatë mbarështimit të pëllumbave.
- Të mbajë shënimet përkatëse për punën e kryer gjatë rritjes së pëllumbave.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesit për mbarështimin e pëllumbave.

RM 2 Nxënësi ushqen pëllumbat.

Përmbajtja

- Përzgjedhja e ushqimeve për pëllumbat.
- Zbatimi i rregullave për higjienën e ushqimit të pëllumbave.
- Përcaktimi i enëve të ushqimit dhe të ujit.
- Përzgjedhja e llojit të ushqimit të njomë dhe atij të gatshëm.

- Blerja e ushqimit të gatshëm për pëllumbat.
- Pasurimi i menisë së ushqimit me misër, grurë, bizele, luledielli dhe oriz etj.,
- Përlllogaritja e vitaminave dhe lëndëve minerale në ushqim.
- Vendosja e vitaminave në ujë dhe dhënia e ujit brenda në kafaz.
- Vendosja në kafaz e materialeve që plotësojnë nevojat për lëndë minerale.
- Mbajtja e evidencave dhe regjistrimet përkatëse të operacioneve që kryhen.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së operacioneve të punës për ushqyerjen e pëllumbave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përzgjedhë llojet e ushqimeve që konsumojnë më mirë pëllumbat.
- Të zbatojë rregullat e higjienës gjatë ushqyerjes së pëllumbave.
- Të përcaktojë enët e ushqimit dhe të ujit për pëllumbat.
- Të përzgjedhë ushqimet e njoma në çdo kohë (fletë sallate, bar të njomë, etj) dhe të gatshme me lëndët e nevojshme.
- Të blejë ushqime të gatshme në dyqanet e shpendëve.
- Të përdorë në racionin ushqimor, ushqime si: misër, bizele, grurë, oriz, luledielli, etj.
- Të hedhë në ujin e pijshëm vitamina (3 ditë në javë).
- Të vendosë në kafaz enë me tulla të thyera, zhavorr, qymydruri, kripë, etj., për të plotësuar nevojat me lëndë minerale.
- Të mbajë evidencat përkatëse për veprimtaritë e kryera gjatë ushqyerjes së pëllumbave.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së operacioneve të punës për ushqyerjen e pëllumbave.

RM 3 Nxënësi kujdeset për shtimin dhe ushqyerjen e papagajve.

Përmbajtja

- Përgatitja dhe veshja e uniformës së punës.
- Përcaktimi i proceseve të punës që kryhen për ndërtimin e kafazit të papagajve.
- Të përzgjedhë kafazin e gatshëm për mbarështimin e papagajve.
- Përzgjedhja e mjeteve, pajisjeve dhe materialeve për mbarështimin e papagajve.
- Vendosja e shufrave prej druri në kafaz.
- Vendosja e tubave me ujë të pijshëm.

- Përcaktimi i periudhës së çiftëzimit të papagajve.
- Përcaktimi i moshës së femrave për riprodhim.
- Vrojtimi i shtimit të papagajve nëpërmjet çiftëzimit.
- Përcaktimi i periudhës së inkubimit të vezëve.
- Trajtimi i zogjve në inkubator.
- Përcaktimi i teknikës së të ushqyerit.
- Ushqyerja e të vegjëlve në inkubator.
- Përlllogaritja e racionit ushqimor me fruta.
- Përdorimi i perimeve dhe frutave në racionin ushqimor.
- Përzgjedhja ushqimeve të njoma e të tjera për papagajt.
- Dhënia e vitaminave në formë pluhuri me ushqim.
- Përdorimi i lëndëve minerale në ushqim.
- Blerja e ushqimeve të gatshme me vlera të larta ushqyese.
- Zbatimi i masave profilaktike dhe mjekuese në tufën e papagajve.
- Pastrimi mekanik i kafazit për të hequr papastërtitë e ndryshme.
- Përzgjedhja dhe përgatitja e mjeteve që përdoren për pastrimin, larjen e enëve të ushqimit, të ujit dhe të kafazit.
- Mbajtja e evidencave dhe regjistrimet përkatëse të operacioneve që kryhen.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së operacioneve të punës për ushqyerjen dhe mbarështimin e papagajve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë dhe veshë uniformën e punës.
- Të përcaktojë radhën e punës për ndërtimin e kafazit të papagajve.
- Të zgjedhë në pikat e shitjes së shpendëve dekorativë kafazë të gatshëm.
- Të përzgjedhë kafazin e sipas numrit të papagajve që mbarështon.
- Të vendosë në kafaz shufra druri për të qëndruar papagalli.
- Të vendosë nga jashtë kafazit enët e ujit me tub, për të mos krijuar ndotje.
- Të përcaktojë periudhën e çiftëzimit të papagajve (shtator-dhjetor).
- Të përcaktojë moshën për riprodhim të papagajve femra (1 vjeç).
- Të vrojtojë procesin e çiftëzimit në papagajë.
- Të përcaktojë periudhën e inkubimit të vezëve.
- Të trajtojë zogjtë e papagajve në inkubator.
- Të përzgjedhë teknikat e të ushqyerit të papagajve.
- Të ushqejë të vegjlit në inkubator me shiringë nga goja.
- Të ushqejë papagajtë në kafaz me fruta dhe perime të

- freskëta.
- Të përzgjedhë në racionin ushqimor fruta si: rrush mollë, pjeshkë, etj,
 - Të përzgjedhë për ushqim sallatë jeshile, patate, oriz, krunde me bukë, etj.
 - Të përdorë vitaminat pluhur me ushqime të buta disa herë në javë.
 - Të shtojë në racionin ushqimor bllok mineral, pluhur Ca në periudhën e shtimit me vezë.
 - Të përzgjedhë në dyqanet e shpendëve dekorativë ushqime të gatshme me vlera të larta ushqyese.
 - Të zbatojë masat profilaktike duke kryer vaksinimet dhe mjekimin në momentin e duhur.
 - Të kryejë pastrimin mekanik të kafazit të papagajve nga jashtëqitjet dhe mbeturinat ushqimore.
 - Të përzgjedhë mjetet për pastrimin e enëve të ushqimit, ujit dhe kafazit të papagajve.
 - Të zbatojë rregullat e higjienës dhe sigurimit teknik në punë gjatë rritjes dhe ushqyerjes së papagajve.
 - Të mbajë saktë shënimet përkatëse për punën e kryer.
 - Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së operacioneve të punës për ushqyerjen e mbarështimin e papagajve.

RM 4 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për shërbimet që kryhen gjatë rritjes së shpendëve dekorativ.

Përmbajtja

- Kostot në punët e rritjes së shpendëve dekorativ, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël për rritjen e shpendëve dekorativ.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot në rritjen e shpendëve dekorativ, si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport, amortizime dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për rritjen e shpendëve dekorativ.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës.
- Mësuesi/instruktori mund të organizojë vizita mësimore në pikat e shitjes së shpendëve dekorativ apo edhe në inkubatorë ku rriten ato, për të vëzhguar nga afër proceset e punës që kryhen për të ushqyer dhe mbarështuar shpendët dekorativ.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e operacioneve të punës për ushqyerjen e mbarështimin, si dhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për rritjen e shpendëve dekorativ.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të ushqyerit e mbarështimit të shpendëve dekorativ, si dhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për rritjen e shpendëve dekorativ, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me operacionet e punës që kryhen për ushqyerjen dhe mbarështimin e shpendëve dekorativ.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kujdesin gjatë rritjes së shpendëve dekorativ.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Subjekte që tregëtojnë shpendë dekorativë, zooparqe, rritës privatë, etj.
 - Kafazë të llojeve të ndryshme.
 - Enë ushqimi dhe pirëse uji.
 - Ushqime të gjelbërta dhe fruta të freskëta.
 - Komplet i mjeteve të pastrimit të kafazeve.
 - Paketime me lloje të ndryshme ushqimesh.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Materiale studimore.
 - Video me demonstrime të ndryshme.
 - Materiale në internet për shpendët dekorativë.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimet e murit me tulla (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal
-

3. Moduli “Kujdesi gjatë rritjes së krimbit të mëndafshit”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Prodhim shtazor
Niveli: II
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	KUJDESI GJATË RRRITJES SË KRIMBIT TË MËNDAFSHIT	(M-28-561-11)
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për mirëmbajtjen, funksionimin e pajisjeve e mjeteve për kujdesin gjatë rritjes së krimbit të mëndafshit, marrjen e produktit përfundimtar si dhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për rritjen e krimbit të mëndafshit .	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi ndërton lokalitetin e rritjes së krimbit të mëndafshit. Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">– Përcaktimi i radhës së kryerjes së shërbimeve.– Përcaktimi i lokalitetit për rritjen e krimbit të mëndafshit.– Pajisja me orëditë e rritjes.– Përzgjedhja e veglave të punës e të shërbimit.– Sigurimi i letrave të biruara.– Ndërtimi i shtretërve prej druri.– Vendosja e shtretërve në rreshta.– Dezinfektimi i lokalitetit dhe orëndive të rritjes.– Dezinfektimi mekanik dhe fiziko-kimik.– Ruajtja e parametrave të ambientit.– Sigurimi i temperaturës në proceset metabolike.– Sigurimi i lagështisë normale të ajrit në lokalitetin e rritjes.– Përshtatja e ndriçimit.– Sigurimi i ushqimit.– Ruajtja e parametrave të dendësisë të krimbave.– Zbatimi i rregullave tekniko-higjienike gjatë ngritjes së lokalitetit për rritjen e krimbit të mëndafshit. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– Të përcaktojë siç duhet radhën e kryerjes së shërbimeve gjatë rritjes së krimbit të mëndafshit, nga veza deri në	

mëshikëz.

- Të përgatisë lokalin për rritjen e krimbit të mëndafshit sipas parametrave të duhura.
- Të pajisë lokalin me orenditë e rritjes: shtretër, lesat, listelat.
- Të përzgjedhë veglat e punës e të shërbimit: koshat për gjethe, kanistrat, thika grirëse, gërshërë, letrat e biruara, etj.
- Të sigurojë letrat e biruara në përshtatje me moshën e krimbit të mëndafshit.
- Të ndërtojë shtretërit prej druri në varësi të lokalit të rritjes.
- Të vendosë shtretërit në rreshta gjatë gjithë gjatësisë së sallës.
- Të dezinfektojë lokalin dhe orenditë e rritjes sipas stinëve.
- Të kryejë dezinfektive mekanike dhe fiziko-kimike.
- Të ruajë parametrat kryesorë të ambientit gjatë rritjes së krimbit: ajrimi, temperatura, lagështia, ndriçimi, etj.
- Të sigurojë temperaturën optimale në lokalet e rritjes.
- Të sigurojë lagështinë normale të ajrit në lokalin e rritjes me anë të ajrosjes.
- Të përshtasë ndriçimin (dritën) sipas moshave të rritjes së krimbit të mëndafshit.
- Të sigurojë në sasinë dhe cilësinë e duhur, ushqimin e nevojshëm për rritjen e krimbit të mëndafshit: gjethe dhe lastarë mani.
- Të ruajë parametrat e dendësisë të kimbave për njësi të sipërfaqes.
- Të zbatojë rregullat tekniko-higjenike ngritjes së lokalit për rritjen e krimbit të mëndafshit.

RM 2 Nxënësi kujdeset për çeljen, rritjen dhe ushqyerjen e krimbit të mëndafshit.

Përmbajtja

- Zbatimi i rregullave tekniko-higjenike gjatë fazave të ndryshme të rritjes së krimbit të mëndafshit.
- Tërheqja e farës nga stacioni i rritjes së krimbit të mëndafshit.
- Ruajtja e parametrave të temperaturës dhe të lagështisë në lokalin e rritjes.
- Përgatitja dhe vendosja e letrave të biruara për mbledhjen e kimbave të porsaçelur.
- Vendosja e gjetheve të grira të manit mbi letrat e biruara.
- Mbledhja e larvave të çelura.
- Vendosja e larvave të çelura mbi shtretërit e rritjes.
- Ndërrimi i shtresës (letrës së biruar).
- Sigurimi i sasisë së ushqimit.
- Zbatimi i masave tekniko-higjenike gjatë përgatitjes së

- ushqimit të krimbit të mëndafshit.
- Shpërndarja uniforme e ushqimit.
- Përzgjedhja e krimbave për një rritje uniforme.
- Ruajtja e dendësisë së krimbave.
- Kontrolli për sëmundje e dëmtues.
- Eliminimi i krimbave të pazhvilluar.
- Zbatimi i masave mbrojtëse kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve.
- Kryerja me orar e shërbimeve.
- Mbajtja e evidencave dhe shënimeve përkatëse për shërbimet dhe operacionet që kryhen.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të zbatojë rregullat tekniko-higjenike gjatë fazave të ndryshme të rritjes së krimbit të mëndafshit.
- Të kryejë tërheqjen e farës nga stacioni i rritjes së krimbit të mëndafshit.
- Të ruajë parametrat e temperaturës me anë të termostatit.
- Të ruajë parametrat e lagështisë me anë të larjes dhe ajrosjes së lokalit të rritjes.
- Të përgatisë e vendosë mbi farën e çelur, letrat e biruara për mbledhjen e krimbave të porsaçelur.
- Të vendosë gjethet e grira të manit mbi letrat e biruara.
- Të kryejë mbledhjen e larvave të çelura.
- Të vendosë larvat e çelura sipas moshës mbi shtretërit e rritjes.
- Të kryejë ndërrimin e shtresës (letrës së biruar) sipas moshave të ndryshme të rritjes së krimbit të mëndafshit.
- Të sigurojë sasinë e ushqimit (gjetheve dhe degëzave të manit) sipas moshave të ndryshme të tij.
- Të zbatojë masat tekniko-higjenike gjatë përgatitjes së ushqimit të krimbit të mëndafshit.
- Të kryejë shpërndarjen uniforme të ushqimit mbi shtretërit e rritjes.
- Të realizojë procesin e përzgjedhjes së krimbave për një rritje uniforme.
- Të ruajë dendësinë e krimbave për njësi të sipërfaqes së shtretërve.
- Të kryejë kontrole për evidentimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të krimbit të mëndafshit.
- Të eliminojë krimbat sipas ngjyrës së lëkurës, jashtëqitjes dhe zhurmës karakteristike në të ecur dhe të ushqyer.
- Të zbatojë masat mbrojtëse ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve.
- Të kryejë me orar të gjitha shërbimet në sallën e rritjes.

- Të mbajë evidenca dhe shënime përkatëse për shërbimet e operacionet që kryhen.

RM 3 Nxënësi kujdeset për endjen e mëshikëzës së krimbit të mëndafshit dhe grumbullimin e tyre.

Përmbajtja

- Përcaktimi i shenjave të ndërprerjes së ciklit të zhvillimit të krimbit të mëndafshit.
- Konstatimi i momentit të përgatitjes për endjen e mëshikëzës.
- Sigurimi i materialeve të nevojshme për ngritjen e pyllit.
- Ndërtimi i pyllit (mëshikoreve) për endjen e mëshikëzës.
- Vendosja e pjerrët e mëshikoreve.
- Mbledhja e mëshikëzave.
- Vendosja e mëshikëzave në çarçafë, në kosha dhe sëfundmi në arka të veshura me letra të pastra.
- Transporti i mëshikëzave në pikat e grumbullimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përcaktojë shenjat e ndërprerjes së ciklit të zhvillimit të krimbit të mëndafshit.
- Të konstatojë momentin e përgatitjes së krimbit të mëndafshit për endjen e mëshikëzës.
- Të sigurojë materialet e nevojshme për ngritjen e pyllit (degëza të thata mani, gjineshtre, dushku, shqope, kashtë thekre).
- Të kryejë ndërtimin e pyllit (mëshikoreve) për endjen e mëshikëzës.
- Të vendosë në pozicion të pjerrët mëshikoret në anët dhe në meset e shtretërve.
- Të kryejë mbledhjen e mëshikëzave në afate të ndryshme, në varësi të qëllimit të përdorimit të tyre (për industri dhe për prodhim fare).
- Të grumbullojë mëshikëzat sipas cilësisë, madhësisë, pastërtisë dhe formës së tyre.
- Të vendosë mëshikëzat në çarçafë, në kosha dhe sëfundmi në arka të veshura me letra të pastra.
- Të kryejë transportin mëshikëzave në pikat e grumbullimit sipas afateve të përcaktuara .

RM 4 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për shërbimet që kryhen gjatë rritjes së krimbit të mëndafshit.

Përmbajtja

- Kostot në punët e rritjes së krimbit të mëndafshit, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).

- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël për rritjen e krimbit të mëndafshit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot në rritjen e krimbit të mëndafshit, si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport, amortizime dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për rritjen e krimbit të mëndafshit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin enxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e fermave ku rritet krimbi i mëndafshit.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për ndërtimin e lokalit, çeljen, rritjen e të ushqyerin e krimbit të mëndafshit, për endjen e mëshikëzës së krimbit të mëndafshit e grumbullimin e tyre, si dhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për rritjen e krimbit të mëndafshit .
- Instruktori mund të realizojë vizita mësimore në fermat ku rritet krimbi i mëndafshit, për të vëzhguar konkretisht të gjitha shërbimet që kryhen në faza të ndryshme të rritjes së krimbit të mëndafshit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për për ndërtimin e lokalit, çeljen, rritjen e të ushqyerin e krimbit të mëndafshit, për endjen e mëshikëzës së krimbit të mëndafshit e grumbullimin e tyre, si dhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për rritjen e krimbit të mëndafshit, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punëve që kryhen gjatë rritjes së krimbit të mëndafshit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për për ndërtimin e lokalit, çeljen, rritjen e të ushqyerin e krimbit të mëndafshit, për endjen e mëshikëzës së krimbit të mëndafshit e grumbullimin e tyre, si dhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për rritjen e krimbit të mëndafshit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen lokale, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Fermë (lokal) për rritjen e krimbit të mëndafshit.
 - Vegla pune, orendi dhe pajisje për të punuar me krimbin e mëndafshit: shtretër, lesa, listela, kanistra, kosha, arka, thika grirëse, gërshërë krasitëse, fshesa kova, lopata, pompa spërkatëse, etj.
 - Termometra, matës të lagështisë, termostat, etj.
 - Dezinfektantë të ndryshëm: sodë kaustike, gëlqerë, formalinë, etj.
 - Ushqime për krimbin e mëndafshit: gjethe e degëza mani, etj.
 - Materiale për ngritjen e mëshikoreve: dega të thata mani, dushku, shqope, kashtë thekre, etj.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Video me demonstrime të shërbimeve të ndryshme që kryhen gjatë rritjes së krimbit të mëndafshit.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimet e murit me tulla (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal
-

4. Moduli “Marrja e mjaltit nga zgjoi i bletëve”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Prodhim shtazor
Niveli: II
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MARRJA E MJALTIT NGA ZGJOI I BLETËVE	(M-28-563-11)
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për mirëmbajtjen, funksionimin e pajisjeve e mjeteve për të kryer ndërhyrje në zgjua për marrjen e mjaltit.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përgatit veglat dhe orenditë për ndërhyrje në zgjua.</p> <p>Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja e vendit ku do kryhet nxjerrja e mjaltit.– Përzgjedhja e veglave dhe orendive të punës për ndërhyrjet në zgjua.– Sigurimi i higjienës së vendit të punës.– Transporti i veglave të punës në vendin e caktuar.– Përgatitja e veshjes speciale për ndërhyrjet në zgjua.– Dezinfectimi i veglave dhe pajisjeve për ndërhyrjet në zgjua.– Përcaktimi i radhës së përdorimit të veglave e orendive.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së veglave e orendive për ndërhyrje në zgjua. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.– Pyetje dhe përgjigje me gojë. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë vendin ku do kryhet marrja e mjaltit, sipas standardit.– të përzgjedhë saktë veglat dhe orenditë për ndërhyrjet në zgjua.– të sigurojë higjienën e vendit të punës, sipas standardit.– të transportojë me kujdes në kohën dhe vendin e duhur veglat dhe orenditë e ndërhyrjes në zgjua.– të përgatitë siç duhet veshjen speciale për ndërhyrje në	

- zgjua.
- të dezinfektojë veglat për marrjen e mjaltit.
 - të përcaktojë saktë radhën e përdorimit të veglave dhe pajisjeve sipas llojit të ndërhyrjes në zgjua: si maskën e fytyrës, dorezat e llastikut, tymësen, levat për hapjen e zgjoit, thikat dhe pirunjat metalik, etj.
 - të zbatojë me korrektësi rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së veglave dhe oerndive për ndërhyrje në zgjua.

RM 2 Nxënësi kryen ndërhyrje në zgjua për marrjen e mjaltit.

Përmbajtja

- Veshja e uniformës speciale për ndërhyrjet në zgjua.
- Ndërhyrja në zgjua.
- Hapja e zgjoit.
- Nxjerrja e kornizave nga zgjoi.
- Transporti i kornizave në centrifugë.
- Vendosja e kornizave në centrifugë.
- Centrifugimi i hojeve të bletës.
- Nxjerrja e hojeve nga centrifuga.
- Vendosja e kornizave për tharje.
- Kullimi dhe grumbullimi i mjaltit.
- Transportimi i enëve të mjaltit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë ndërhyrjes në zgjua për marrjen e mjaltit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën speciale për ndërhyrjen në zgjua.
- të ndërhyjë në zgjua sipas radhës së përcaktuar të punës
- të hapë me kujdes zgjoin.
- të nxjerrë me kujdes kornizat nga zgjoi.
- të transportojë me kujdes kornizat në centrifugë.
- të vendosë kornizat në pozicionin e duhur në centrifugë.
- të centrifugojë hojet e bletëve.
- të nxjerrë me kujdes hojet nga centrifugimi.
- të vendosë me kujdes kornizat në vendin e caktuar për tharje.
- të kullojë dhe grumbullojë mjaltin në enë të veçanta.
- të transportojë enët e mjaltit në vendin e caktuar.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë ndërhyrjeve në zgjua për marrjen e mjaltit.

RM 3 Nxënësi pastron mjetet dhe veglat e përdorura gjatë marrjes së mjaltit.

Përmbajtja

- Veshja e uniformës.
- Përzgjedhja e veglave dhe mjeteve për pastrim.
- Përcaktimi i rradhës së pastrimit.
- Pastrimi i centrifugës.
- Pastrimi i veglave që janë përdorur gjatë marrjes së mjaltit.
- Pastrimi i kornizave të thara.
- Vendosja e kornizave në vendin e caktuar.
- Transportimi i mjeteve dhe veglave të pastruara në vendin e caktuar.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë pastrimit të veglave dhe mjeteve të përdorura gjatë marrjes së mjaltit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën.
- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për pastrim.
- të përcaktojë saktë radhën e punës.
- të pastrojë me kujdes centrifugën.
- të pastrojë veglat që janë përdorur gjatë marrjes së mjaltit.
- të pastrojë me kujdes kornizat e thara.
- të vendosë me kujdes kornizat në vendin e caktuar.
- të transportojë me kujdes mjetet dhe veglat e pastruara në vendin e caktuar.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë pastrimit të veglave dhe mjeteve që janë përdorur gjatë marrjes së mjaltit.

RM 4 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për shërbimet që kryhen gjatë rritjes së bletëve.

Përmbajtja

- Kostot në punët e rritjes së bletës në koshere, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël për rritjen e bletës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot në rritjen e bletës, si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore,

etj.), sipas manualit përkatës.

- të njehsojnë kostot e tjera (transport, amortizime dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për rritjen e bletës.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional pranë shkollës ose në park bletësh.
- Instruktori mund të organizojë vizita mësimore në park bletësh duke iu dhënë mundësi nxënësve për të vrojtur konkretisht disa nga shërbimet që bëhen për mirërritjen e tyre.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të përdorimit sa më të mirë të veglave të punës, orendive dhe pajisjeve në një park bletësh si dhe të kryerjes së punëve për marrjen e mjaltit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete të kryerjes së punëve për marrjen e mjaltit vetëm në mbikqyrje të instruktorit apo specialistit të rritjes ë bletëve.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për kryerjen e marrjes së mjaltit të bletëve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të kryerjes së punëve për marrjen e mjaltit të bletëve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Park për rritjen e bletëve.
 - Vegla pune, orendi dhe pajisje për të punuar me bletën.
 - Centrifugë mjalti, kova, fuçi, bidona.
 - Veshje speciale, maska për fytyrën, doreza llastiku, tymëse, etj.
 - Pite, korniza me hoje.
 - Vazo e fuçi me rubinet, pjata, tava,
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Video me demonstrime të ndryshme.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimet e murit me tulla (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-